



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në
“Menaxhim Informacioni në Agrobiznes”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Elson Agastra

2. Dr. Irma Shyle

Korrik / 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes”
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Bujqësor i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Matematikës dhe Informatikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Menaxhim Informacioni në Agrobiznes
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Nr. 673, datë 12.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 30, datë 01.02.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë, Master Profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestër
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14 / 1
18	Numri i studentëve:	32
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Universiteti Bujqësor i Tiranës, është një institucion publik i arsimit të lartë, i licencuar në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 548, datë 28.VII.1951 me statusin si “Institut i Lartë Bujqësor”

Universiteti Bujqësor i Tiranës, me njësitë kryesore të tij është akredituar institucionalisht në 16.12.2021 me vendimin nr. 59, të Bordit të Akreditimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), me kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite deri më 15.12.2026.

Universiteti Bujqësor i Tiranës përbëhet nga gjashtë njësi kryesore, dhe secili prej tyre ka në përbërje njësitë bazë, të organizuara si më poshtë (Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT):



1. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit
 - i. Departamenti i Teknologjisë Agroushqimore
 - ii. Departamenti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë
 - iii. Departamenti i Kimisë
 - iv. Qendra Kërkimeve dhe Ushqimit
2. Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit
 - i. Departamenti i Shkencave Agronomike
 - ii. Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit
 - iii. Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve
 - iv. Departamenti i Shkencave Zooteknike
 - v. Departamenti i Akuakulturës dhe Peshkimit
 - vi. Departamenti i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore
3. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit
 - i. Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit
 - ii. Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural
 - iii. Departamenti i Financë – Kontabilitet
 - iv. Departamenti i Matematikës dhe Informatikës
 - v. Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural
 - vi. Departamenti i Gjuhëve të Huaja
4. Fakulteti i Mjekësisë Veterinare
 - i. Departamenti i lëndëve apo module Morfofunktionale
 - ii. Departamenti i Shëndetit Publik Veterinar

- iii. Departamenti i lëndëve Paraklinike
 - iv. Departamenti i lëndëve Klinike
5. Fakulteti i Shkencave Pyjore
- i. Departamenti i Pyjeve
 - ii. Departamenti i Industrisë së Drurit
 - iii. Departamenti i Fizikës dhe Shkencave të Aplikuara
6. Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit është njësi kryesore e cila ofron programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes”. Njësia bazë përgjegjëse për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është **Departamenti i Matematikës dhe Informatikës**. Kjo njësi bazë, së bashku me njësi të tjera akademike si dhe strukturave ndihmës akademike, administrative, japin kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ, në funksion të programit të studimit

Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” në shqyrtim ofrohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL” dhe akteve nënligjore në funksion të tij. Ky program studimi zhvillohet në dy vite akademike me 120 kredite ECTS.

Raporti i paraqitur në këtë dokument, si më poshtë vijon, është një vlerësim në kuadër të akreditimit për herë të parë të këtij programi studimi.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Mbështetur në VKM nr.109, datë 15.05.2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bsc. në “Teknologji Informatike”.

Bazuar në Urdhrin nr. 19, datë 20.02.2023 “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, grupi i vlerësimit përbëhet nga:

1. Prof. Dr. Elson Agastra

2. Dr. Irma Shyle

Gjatë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Znj. Endra Velaj.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Janar 2023 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti Bujqësor i Tiranës për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti Bujqësor i Tiranës, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Gjatë vizitës së kryer në UBT, në datat 16 dhe 17 Mars 2023, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterave, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave.

Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Më datë 04/04/2023, përmes sistemit AMS, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm, i njoftuar edhe me shkresë zyrtare me Nr. 38/51 Prot., datë 26.05.2023.

UBT kthehu përgjigje, me shkresë zyrtare, më datë 19/06/2023 e protokolluar në ASCAL me Nr. 38/54 Prot., datë 19.06.2023.

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:

1. Koment i UBT

Standardi II.1, Kriteri 3, “Praktika Profesionale e programit të studimit, zhvillohet duke u bazuar në rregulloren e programit të studimit, neni 13 për organizimin dhe vlerësimin e praktikave profesionale. Sugjerimi juaj është i dobishëm dhe fakulteti në bashkëpunim me departamentin, do realizojë hartimin e sllabusit të sugjeruar”

Institucioni ka mirëpritur sugjerimin e hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm, si një dokumentim për tu plotësuar në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale. Informacion, që gjithsesi, është plotësues në rritjen e transparencës me studentët por nuk prek në thelb cilësinë e programit të studimit.

Vlerësimi në tërësi i këtij standardi, nuk ndryshon, pasi sugjerimi i më sipërm nuk ka qenë shkak për vlerësimin e këtij standardi me “përmbushet kryesisht”.

2. Koment i UBT


Standardi II.3, Kriteri 2, “Formati i planti mësimor, i cili pasqyron qartazi të gjitha aktivitetet didaktike, së bashku dhe me listën e dokumentacionit të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor miratohen në rektorat dhe janë dokumenta standarde. Sugjerimi i juaj do të transmetohet në zyrat përkatës për shtimin e elementëve që lidhen me ndarjen e krediteve”

Institucioni dhe në veçanti njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi ka mirëpritur sugjerimin e hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm, si një informacioni i nevojshëm jo vetëm për rritjen e transparencës në lidhje me aktivitetet didaktike të ofruara, por edhe në vlerësimin sasior të mjaftshmërië së aktiviteteve specifike didaktike dhe ambienteve përkatëse për secilin aktivitet (leksione, seminare, laboreatore, praktika etj.)

Informacione që në gjykimin e grupit të vlerësimit të jashtëm, janë të nevojshme, por nuk janë në mundësinë e zbatimit nga njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit, por bazohen në vendimet në rang institucioni.

Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti me stafin drejtues dhe atë akademik të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, qartazi ndihej dhe ishte i mirëpritur nevoja e detajimeve të paraqitura nga GVJ në këtë raport, por që kërkojnë vendimmarrje institucionale dhe koordinim me të gjitha njësitë kryesore dhe bazë të UBT.

Vlerësimi i këtij standardi, ndryshon, pasi nuk është në mundësinë e njësisë bazë të përmirësojë këtë gjetj.



3. Koment i UBT

Standardi II.3, Kriteri 3, “Diskutimi rreth këtij sugjerimi ka filluar që në këtë periudhë, duke i vënë prioritet kritereve specifike kryesisht të nivelit bachelor, në funksion të rritje së cilësisë së studentëve që do të pranohen në këtë program”

Institucioni dhe në veçanti njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi ka mirëpritur sugjerimin e hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm, informacion që u analizua nga njësi bazë, që ditën e parë të vizitës së GVJ në institucion.

Vlerësimi i këtij standardi, ndryshon nga “Përmbushet kryesisht” në “Përmbushet plotësisht”.

4. Koment i UBT

Standardi II.7, konkluzione, “Kurrikula e këtij programi studimi është hartuar duke ju referuar programeve analoge ndërkombëtare dhe konsultuar nga ekspertë që e njohin mirë tregun ndërkombëtar.

Projektet e financuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe FAO për dixhitalizimin e bujqësisë në Shqipëri, janë një mundësi e mirë për përfshirjen e studentëve si në tregun kombëtar edhe atë ndërkombëtar të punës.

Dëshirojmë të theksojmë se programi i studimit Master Profesiona “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” është i kodifikuar tashmë bazuar në VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 janë kodifikuar të gjitha programet e FEA-s dhe përcjellë për procedura të mëtejshme (Rekomandimi 4).

Për të rritur numrin e studentëve të rregjistruar në këtë program studimi, departamenti në bashkëpunim me dekanatin ka ndërmarrë një fushatë informuese lidhur me programin e studimit, me të gjithë studentët nivelit bachelor të profilit informatikë biznesi dhe ekonomik, brenda dhe jashtë UBT.

Konsideruar kapacitetet akademike të Departamentit dhe FEA-s, infrastrukturën dhe logjistikën, seriozitetin dhe përkushtimin profesional dhe njerëzor të çdo stadi dhe strukture, ne besojmë fort se ky program është një aset në ofertën akademike të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit.”

Programi i studimit, sikurse vërehet nga komenti më sipër, por që u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion, përkon me angazhimin maksimal të institucionit, stafit akademik dhe atij drejtues. Megjithatë, formimi specifik, aktual i këtij programi studimi, ka një treg pune akoma jo mirë të formuar dhe të saktësuar nga aktorët e biznesit. Kjo ka bërë që edhe formimi aktual i studentëve të marrë një nuancë më të përgjithshme drej fushës së teknologjisë së informacionit, si një fushë më e madhe.



Ne si GVJ, vlerësojmë se institucioni, me impenjim të tij, do të mund të krijojë një praktikë të mirë që profili specifik i këtij programi studimi të jetë i pranuar dhe i kërkuar në tregun e punës, ku edhe këta student të gjejnë veten.

Gjetjet e paraqitura në këtë kriter qëndrojnë, dhe vlerësimi i këtij standardi, nuk ndryshon.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT



Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin Bujqësor të Tiranës, GVJ konstaton se programi i studimit, “Master Profesional në Menaxhim Informacioni në Agrobiznes”, nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Universiteti Bujqësor i Tiranës, përpara hapjes së këtij programi studimi, ka realizuar një analizë të tregut të punës, dhe bazuar në analizën e njësisë bazë, Senati Akademik i Universitetit Bujqësor të Tiranës, me Vendimin Nr. 13, datë 06.03.2017 ka miratuar hapjen e këtij programi. Program studimi, i cili pas miratimit nga senati akademik, është hapur në përputhje me Urdhër Nr, 673, datë 12.10.2018 për “Hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit “Master Profesional në Menaxhim Informacioni në Agrobiznes në Universitetin Bujqësor të Tiranës”, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. [Dok.2. Statuti i UBT], [Dok.3. Plani Strategjik UBT_2016-2025], [Dok.12. Vendim Senati për hapjen e PS MIA], [Dok.13. Urdhër nr. 673 dt. 12.10.2018 për hapje programi FEA_MP_MIA]
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë në Shqipëri. Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes”, ruan dhe konsolidon vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. [Dok.12. Vendim Senati për hapjen e PS MIA], [Dok.13. Urdhër nr. 673 dt. 12.10.2018 për hapje programi FEA_MP_MIA]
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	GVJ konstaton se ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e IAL dhe është bazuar dhe në një studim të detajuar tregu, për të qenë konkurrues në një treg kombëtar dhe ndërkombëtar. Veprimtari e cila është analizuar në njësinë bazë përgjegjëse për këtë program, miratuar në dekanatin e Fakultetit të Ekonomisë dhe



	<p>Agrobiznesit, miratuar në Senatin Akademik të UBT dhe më pas, miratuar në ministrinë përgjegjëse për arsimin.</p> <p>[Dok.2. Statuti i UBT], [Dok.3. Plani Strategjik UBT_2016-2025], [Dok.12. Vendim Senati për hapjen e PS MIA], [Dok.13. Urdhër nr. 673 dt. 12.10.2018 për hapje programi FEA_MP_MIA], [Dok.26. Studim i tregut të punës përpara hapjes së programit]</p>		
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, rezulton se UBT realizon në mënyrë periodike studime të tregut të punës në lidhje me fushën e këtij programi studimi. Edhe para hapjes së programit të studimit ka një studim të tregut lokal të punës. Gjithashtu, KPT përpunon të dhëna mbi kërkesën e tregut të punës, bazuar edhe në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka me aktorët kombëtar si punëdhënës potencial për studentët e këtij profili.</p> <p>[Dok.13. Urdhër nr. 673 dt. 12.10.2018 për hapje programi FEA_MP_MIA], [Dok.26. Studim i tregut të punës përpara hapjes së programit]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit, Master profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” ofrohet në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në përputhje të plotë me misionin, qëllimin dhe aktivitetin e tij.</i></p> <p><i>Programi i studimit bazohet në studime periodike dhe nevojave të tregut të punës.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p> <p>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës, është një nga institucionet më të vjetra të arsimit të lartë në Shqipëri. Si i tillë, rezulton një nga institucionet e arsimit të lartë me përvojë të lartë në fushën akademike dhe atë kërkimore shkencore.</p> <p>Stafi akademik, ndihmës akademik dhe administrativ i njësisë kryesore, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA) dhe i njësisë bazë, Departamenti i Matematikës dhe Informatikës (DMI), është me përvojë në mësimdhënie dhe i kualifikuar në fushat specifike që mbulojnë këtë program studimi.</p> <p>FEA, si njësia kryesore që ofron këtë program studimi përbëhet nga 89 anëtarë staf akademik me kohë të plotë dhe 8 anëtarë staf ndihmës</p>

	<p>akademik; DMI, njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi ka 20 anëtarë staf akademik dhe 2 anëtar staf ndihmës akademik, nga të cilët, kualifikimi është si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2 Prof. Dr. - 5 Prof. Asoc. - 7 Dr. - 6 Dr. në proces <p>Burimet njerëzore: Staf akademik bazuar në CV-të rezulton me përvojë dhe i përshtatshëm në disiplinat specifike të këtij programi studimi.</p> <p>[Dok.2. Statuti i UBT], [Dok.3. Plani Strategjik UBT_2016-2025], [Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.16. CV e Stafit Akademik të Programit të Studimit MP_MIA], [Dok.75. Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB]</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësia kryesore, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, ofron programe studimi në fushën e Matematikës, Matematikës së aplikuar, Informatikës dhe fushave të lidhura me to.</p> <p>Departamenti i Matematikës dhe Informatikës ofron katër programe studimi në tre cikle sipas niveleve 5, 6 dhe 7 të kornizës kombëtare të kualifikimeve, dhe përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Niveli 5, Program profesional 2-vjeçar në “Menaxhim Sistemesh Informacioni” - Niveli 6, Bachelor në “Informatikë Biznesi” - Niveli 7, Master i Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” - Niveli 7, Master i Shkencave (tabela 3 në RVB, mungon emërtimi)
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e programit të studimit Menaxhim Informacioni në Agrobiznes, është në përputhje me fushën akademik dhe kërkimore të Departamentit të Matematikës së Aplikuar është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe në veçanti të asaj të njësisë bazë.</p> <p>Për sa i përket kodifikimit të programeve/ klasifikimit, referuar RVB-së dhe VKM nr. 310, datë 11.05.2022 për “specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kodifikimi i këtij programi studimi nuk është përcaktuar akoma nga institucioni.</p> <p>Megjithatë, nga analiza e programeve të lëndëve, ato janë në përputhje me objektivat e këtij programi studimi dhe të ngjashme me ato të institucioneve të tjera kombëtare që ofrojnë programe studimi analoge.</p>

	[Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.7. Rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ], [Dok.75. Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB]		
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	- Nuk aplikohet -		
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Universiteti Bujqësor i Tiranës ofron në terisë trajnime apo aktivitete profesionale jashtë universitare, sikurse është shembulli i aktiviteteve të realizuara nga “Forumit Ekonomik Studentor”. Megjithatë, nuk vërehet një aktivizim apo trajnime profesionale në profilin e këtij programi studimi. [Dok.28. Marrëveshje Bashkëpunimi me Institucionet Homologe dhe Aktorë Biznesi], [Dok.29. Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT]		
Konkluzione	<i>Fusha akademike e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe ajo e njësisë bazë, Departamenti i Matematikës dhe Informatikës, janë në përputhje me profilin e programit të studimit Master i Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes”</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ndarja e detyrave mes njësive dhe personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren e tij dhe në atë të njësive bazë. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Matematikës dhe Informatikës, menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të dytë, Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” i cili ka një kohëzgjatje 2-vjeçare me 120 kredite. Vërehet një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit (Njësia e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe protokollit, Zyra e burimeve njerëzore, Zyra e zhvillimit të kurrikulave, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë etj.) dhe departamentet e tjera brenda Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe në tërësi në

	<p>Universitetin Bujqësor të Tiranës që rrit efektivitetin e këtij programi studimi.</p> <p>[Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.5. Rregullore e njësisë kryesore FEA], [Dok.64. Manuali i Cilësisë UBT]</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ bazuar në informacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, si dhe në takimin me përfaqësuesin e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe të projekteve, vlerëson se UBT, dhe në veçanti Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi si me institucione të tjera të arsimit të lartë ashtu edhe me subjekte ekonomike private dhe institucione të tjera shtetërore.</p> <p>Nga takimi me studentët, me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, me zyrën përgjegjëse për marrëdhëniet më jashtë, u konstatua se institucioni ka bashkëpunime me IAL-të vendase dhe të huaja apo me kompani biznesi. Gjithashtu vihet re edhe rritja e kërkesës dhe angazhimit në aktivitete ndërkombëtare si Erasmus+.</p> <p>[Dok.27. Kapacitete dhe të dhëna për infrastrukturën FEA], [Dok.28. Marrëveshje Bashkëpunimi me Institucionet Homologe dhe Aktorë Biznesi], [Dok.29. Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT]</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes se rezulton, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në veçanti Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik.</p> <p>Partnerët e biznesit krijojnë mundësi bashkëpunimi si në ide dhe opinione në zhvillimin e programit të studimit sipas nevojave të tregut të punës por edhe në formimin e përgjithshëm të studentëve.</p> <p>Institucioni, nëpërmjet Qendrës së Karrierës dhe ALUMNI, ndihmon studentët në gjetjen e mundësive për zhvillimin e karrierës.</p> <p>[Dok.27. Kapacitete dhe të dhëna për infrastrukturën FEA], [Dok.28. Marrëveshje Bashkëpunimi me Institucionet Homologe dhe Aktorë Biznesi], [Dok.29. Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT], [Dok.37. Qendra e Karrierës dhe ALUMNI, UBT]</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në fund të vitit akademik, departamenti DMI realizon analizën e punës mësimore dhe shkencore ku përveç aspekteve të tjera të punës që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e këtij programi studimi, shqyrton dhe analizon marrëveshjet e bashkëpunimit. Në këto analiza evidentohen efektet pozitive dhe përfitimet e këtyre marrëveshjeve në funksion të realizimit të qëllimeve të këtij programi studimi, por edhe të evidentimit të mangësive të tyre.</p>


	[Dok.29. Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT], [Dok.39. Raporti GRADUA - Vrojtimi i profilit të studentëve], [Dok.41. Raport Panairi i Karrierës, 2022]			
Konkluzione	<i>Universiteti Bujqësor i Tiranës, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere si dhe aktor të tregut të punës. Kjo në kuadër të praktikave profesionale si dhe bashkëpunimeve në projekte dhe infrastrukturë mbështetëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Ai ofrohet në 2 vite akademike, 4 semestra, dhe me kohë të plotë. Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” përmban 120 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) konform VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar.</p> <p>Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p>Megjithatë, institucioni ka parashikuar në planin mësimor si dhe në syllabuset e lëndëve numrin total të krediteve ECTS por jo ndarjen e tyre</p>


	<p>në aktivitete formuese si Leksione, Ushtrime/Seminare, Laboratorë, detyra/Projekte kursi, etj.</p> <p>Në planin mësimor janë të parashikuara vetëm dy aktivitete didaktike formuese, Leksione dhe Seminare. Nuk ka të parashikuara aktivitete didaktike si Laborator apo detyra/projekte kursi.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve, është paraqitur si informacion shtesë, informacioni që citojmë:</p> <p><i>[...studentët do të kenë mundësinë e zbatimit praktik të lëndëve në laboratorët e degës “Informatikë Biznesi”. Kjo do t’ju shërbejë për vënin në zbatim të të gjitha koncepteve teorike të marra gjatë lëndës...]</i></p> <p>Gjithashtu, në rregulloren e programi të studimit, në veçanti neni 27, parashikohet që studentët e këtij programi studimi duhet të frekuentojnë së paku 80% të orëve laboratorike. Por në planin mësimor, nuk ka të përcaktuara orë laboratorike për asnjë nga lëndët e këtij programi.</p> <p>Pavarësisht, mos paraqitjes në planin mësimor dhe në syllabuset përkatëse, sidomos për aktiviteteve laboratorike, zhvillimi i këtij programi studimi kryesisht në fundjavë apo në orar pasdite, si dhe numri i ulët i studentëve të regjistruar, ka mundësuar përdorimin e ambienteve laboratorike të institucionit për zhvillimin e aktiviteteve të seminareve ku studentët kanë praktikuar në ambient laboratorik njohuritë e tyre.</p> <p><i>Megjithatë, ne si GVJ sugjerojmë institucionin të hartojë planin mësimor si dhe syllabuset e lëndëve, të tilla që të paraqesin qartazi të gjitha aktivitetet didaktike (leksione, seminare, laborator, detyra kursi etj.), të ndara si në kredite, ashtu edhe në orë mësimore në auditor.</i></p> <p>[Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA], [Dok.75. Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse</p>	<p>Programi mësimor i studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, Datë 04.03.2010, “Për Kuadrin e Kualifikimeve Shqiptare”, të ndryshuar. Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes, i korrespondon Nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Më poshtë janë specifikuar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studentët në programin Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” do të zotërojnë sipas Nivelit 7 të Kornizës Shqiptare: Arsimim të thelluar profesional të studentëve në fushën e informatikës,</p>




<p>dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>programimit, sistemeve të informacionit dhe ekonomisë si dhe njohuri në kërkimin empirik.</p> <p>[Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA], [Dok.75. Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>Plani mësimor parashikon në total 18 lëndë mësimore, praktikën profesionale si dhe tezën e diplomës, për një total prej 20 lëndë/module didaktike të ndara në veprimtari formuese në kategoritë A-E sipas VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar.</p> <p>Praktika profesionale është parashikuar në kategorinë “D” si lëndë plotësuese, me 12 kredite ECTS. Megjithatë, për këtë aktivitet nuk është parashikuar një plan-program lënde dhe as numri i orëve në auditor.</p> <p>Teza e diplomës është e parashikuar si detyrime përmblyëse me 18 kredite ECTS në kategorinë “E”.</p> <p><i>Ne si GVJ sugjerojmë institucionin, që edhe për praktikën profesionale, të hartojë një syllabus, ku të përshkruhen së paku detyrimet e studentit për vlerësimin e saj, si dhe detyrimet e studentit në zhvillimin e saj.</i></p> <p>[Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>- Nuk aplikohet -</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>- Nuk aplikohet -</p>





<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Organizimi i studimeve të këtij programi studimi realizohet me kohë të plotë pranë institucionit me një kohëzgjatje 2 vite akademike e ndarë në katër semestra.</p> <p>Lëndët janë të përcaktuara me kredite, ku një vit akademik përbën një ngarkesë prej 60 kredite ECTS dhe 120 kredite ECTS në total.</p> <p>Lëndët janë të ndara në veprimtari formuese sipas kategorive A-E në përputhje me udhëzimet e VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar dhe më konkretisht:</p> <table border="1" data-bbox="564 546 1401 965"> <thead> <tr> <th>Veprimtari formuese</th> <th>Kredite ECTS</th> <th>Përqindje</th> <th>Kriteri</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Lëndë bazë (A)</td> <td>10</td> <td>8.3 %</td> <td>5% - 10%</td> </tr> <tr> <td>Lëndë karakterizuese (B)</td> <td>45</td> <td>37.5 %</td> <td>30% – 40%</td> </tr> <tr> <td>Lëndë ndërdisiplinore/ integruese (C)</td> <td>35</td> <td>29.2 %</td> <td>20% – 30%</td> </tr> <tr> <td>Lëndë plotësuese (D)</td> <td>12</td> <td>10.0 %</td> <td>10 %</td> </tr> <tr> <td>Detyrime përmbyllëse (E)</td> <td>18</td> <td>15.0 %</td> <td>10% – 20%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ndarja e lëndëve në aktivitete formuese është në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.</p> <p>[Dok.2. Statuti i UBT], [Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.50. Propozimi i Krihereve 2023-2024]</p>	Veprimtari formuese	Kredite ECTS	Përqindje	Kriteri	Lëndë bazë (A)	10	8.3 %	5% - 10%	Lëndë karakterizuese (B)	45	37.5 %	30% – 40%	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese (C)	35	29.2 %	20% – 30%	Lëndë plotësuese (D)	12	10.0 %	10 %	Detyrime përmbyllëse (E)	18	15.0 %	10% – 20%
Veprimtari formuese	Kredite ECTS	Përqindje	Kriteri																						
Lëndë bazë (A)	10	8.3 %	5% - 10%																						
Lëndë karakterizuese (B)	45	37.5 %	30% – 40%																						
Lëndë ndërdisiplinore/ integruese (C)	35	29.2 %	20% – 30%																						
Lëndë plotësuese (D)	12	10.0 %	10 %																						
Detyrime përmbyllëse (E)	18	15.0 %	10% – 20%																						
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>- Nuk aplikohet -</p>																								
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Për sa i përket kodifikimit të programeve/ klasifikimit, referuar raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumentacionit shoqërues si dhe VKM nr. 310, datë 11.05.2022 për “Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kodifikimi i këtij programi studimi nuk është përcaktuar akoma nga institucioni, kjo duke parë edhe datën e miratimit të VKM përkatëse.</p> <p>Programi i studimi ka të përcaktuar vetëm kodin e identifikimit të këtij programi studimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, kod që përdoret nga institucioni në lëshimin e diplomave për këtë program studimi.</p> <p>[Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23]</p>																								




Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	- Nuk aplikohet -			
Konkluzione	<p><i>Në tërësi, dokumentacioni dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.</i></p> <p><i>Sugjerojmë hartimin e një syllabusi edhe për praktikën profesionale.</i></p> <p><i>Institucioni të marrë masa në zbatimin e detyrimeve që lindin nga VKM 310, datë 11.05.2022 për "Specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.2												
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.												
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve											
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit, Master Profesional në Menaxhim Informativ në Agrobiznes, është Departamenti i Matematikës dhe Informatikës, pjesë e njësisë kryesore, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit.</p> <p>Njësia kryesore, ka në përbërjen e sajë gjashtë njësi bazë si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Drejtimit të Agrobiznesit 2. Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural 3. Departamenti i Financë – Kontabilitet 4. Departamenti i Matematikës dhe Informatikës 5. Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural 6. Departamenti i Gjuhëve të Huaja <p>Duke përmbushur kriterin minimali prej tre njësi bazë, të kërkuar nga ligji 80/2015 për arsimin e lartë.</p> <p>Njësia bazë përgjegjëse, në tre vitet e fundit akademike ka qenë e përbërë si më poshtë vijon:</p> <table border="1" data-bbox="564 1749 1390 1861" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 25%;">Kualifikimi</th> <th style="width: 25%;">2022 – 2023</th> <th style="width: 25%;">2021 – 2022</th> <th style="width: 25%;">2020 – 2021</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td style="text-align: center;">2</td> <td style="text-align: center;">1</td> <td style="text-align: center;">1</td> </tr> </tbody> </table>				Kualifikimi	2022 – 2023	2021 – 2022	2020 – 2021	Prof. Dr.	2	1	1
Kualifikimi	2022 – 2023	2021 – 2022	2020 – 2021									
Prof. Dr.	2	1	1									

Prof. Asoc.	5	5	4
Dr./PhD	7	7	8
Dr. Proces.	6	7	0
Msc	0	0	6
Total	20	20	19

Nga ku vërehet se njësia bazë, plotëson kriteret minimale të parashikuara në ligjin 80/2015 për arsimin e lartë.

Madje, vërehet një rritje e kualifikimit të stafit të kësaj njësi bazë, ku ë gjithë asistent lektorët me kualifikimin Master i Shkencave që kanë qenë pjesë e kësaj njësie, nga viti akademik 2020-2021 në vitin akademik 2021-2022 janë regjistruar të gjithë në shkollë doktorale. Kategorisë “Asistent Lektor”, në vitin 2021-2022, i është shtuar edhe një staf tjetër i cili po ashtu, është duke ndjekur studimet doktorale.

Në këtë vit akademik, një staf me kualifikimin “Doktor” është promovuar duke fituar titullin akademik “Profesor i Asociuar”.

Në vitin akademik 2022-2023, kësaj njësie bazë i është shtuar një staf akademik me kohë të plotë, me titull akademik “Profesor”, personel që në vitet më parë ka qenë i angazhuar si staf me kohë të pjesshme. Gjithashtu, në këtë vit akademik, një staf akademik i kategorisë “Asistent Lektor”, është larguar.

Vërehet se në tërësi, stafi akademik i njësive bazë, përgjegjëse për këtë program studimi, është i qëndrueshëm dhe i kualifikuar në fushën e tyre të ekspertizës.

[ASCAL - Verifikimi i Stafit Akademik - UBT - 19.09.2022], [Dok.75. Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB]

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Për mirëfunksionimin e këtij programi studimi, njësia bazë, angazhon edhe 2 staf si personel ndihmës akademik.

Gjithashtu, në funksion jo vetëm të këtij programi studimi, por në tërësi të të gjitha programeve të studimit të ofruara nga njësia kryesore në veçanti dhe nga institucioni në tërësi është edhe sekretaria mësimore. Sekretaria mësimore është një e përgjithshme për të gjithë Universitetin Bujqësor të Tiranës, duke rezultuar në një angazhim më optimal të burimeve njerëzore si dhe në procedura të unifikuara për studentët e të gjithë programeve të studimit të ofruara nga ky institucion.

[Dok.75. Tabelat përmbledhëse ANEKS RVB]



<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Institucioni cakton për çdo program studimi nga një koordinator nga stafi akademik i angazhuar në atë program studimi dhe anëtar i njësive bazë përgjegjëse për to.</p> <p>Për programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Informacioni në Agrobiznes, koordinatori është caktuar përgjegjësi i departamentit, personel akademik me titull akademik “Profesori i Asociuar”. Personel me përvojë në fushën e këtij programi studimi.</p> <p><i>Ne si GVJ sugjerojmë institucionin, që në përcaktimin e koordinatoreve të programeve të studimit, të caktojë personel akademik me përvojë, por që nuk është i angazhuar në nivele drejtuese. Kjo për të lehtësuar dhe plotësuar punën administrative të drejtueseve (dekan, drejtues departamenti etj.) me ato të koordinatoreve të programeve të studimit.</i></p> <p>[Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia kryesore, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit si dhe njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, Departamenti i Matematikës dhe Informatikës, plotësojnë kriteret ligjore si në numër, organizim ashtu edhe në kualifikimin e stafit akademik.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, vërejmë se njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si rregulloren dhe programin mësimor. Të dhëna që janë edhe në nivel të njësisë kryesore.</p> <p>[Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA]</p> <p>[Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit përmban informacion të përgjithshëm për ngarkesën mësimore në auditor, por nuk është i detajuar në ngarkesën në kredite dhe orë mësimore për secilin aktivitet didaktik në</p>




<p>nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>veçanti. Më konkretisht, në planin mësimor janë parashikuar vetëm dy tipologji aktiviteteve didaktike si Leksione dhe Ushtrime. Këto janë të përcaktuara si orë mësimore dhe jo si kredite përkatëse. Gjithashtu, disa prej lëndëve, edhe pse realisht zhvillojnë aktivitete laboratorike (simulime/projekte kompjuterike), nuk paraqesin në syllabus këtë lloj aktiviteti didaktik, as si ngarkesë kreditesh as si orë mësimore. Edhe pse, është e përcaktuar si aktivitet vlerësues edhe në rregulloren e programit të studimit, ku në veçanti neni 27, parashikohet që studentët e këtij programi studimi duhet të frekuentojnë së paku 80% të orëve laboratorike</p> <p><i>Megjithatë, ne si GVJ sugjerojmë institucionin të hartojë planin mësimor si dhe syllabuset e lëndëve, të tilla që të paraqesin qartazi të gjitha aktivitetet didaktike (leksione, seminare, laborator, detyra kursi etj.), të ndara si në kredite, ashtu edhe në orë mësimore në auditor.</i></p> <p>Plani mësimor përmban të detajuar ndarjen e lëndëve në semestër dhe vite akademike, sikurse edhe lëndët me zgjedhje të mundshme.</p> <p>[Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Pranimi i studentëve bazohet në aktet e brendshme rregullatore, duke përcaktuar kriteret e veçanta për pranimin në vartësi të programit specifik të studimit. Megjithatë, referuar pranimit të studentët në këtë program studimi, vërehet se institucioni ka hartuar kriteret specifike të cilat nuk i përfshijnë apo motivojnë studentët që kanë mbaruar studimet bachelor jashtë fushë së studimit në ekonomi.</p> <p>Studentët që kanë mbaruar studimet bachelor në fushën e ekonomisë, nota e tyre e ponderuar e studimeve bachelor peshohet me një koeficient që varion nga 0.8 në 1 nëse kanë mbaruar në fushën e ekonomisë jashtë UBT apo në UBT.</p> <p>Për studentët të cilët kanë mbaruar studime në UBT, jashtë profilit ekonomik, nota e tyre e studimeve bachelor peshohet me koeficientin 0.75.</p> <p>Sipas këtij kriteri, studentët e drejtimeve bachelor në Informatikë Biznesi, po në UBT, vlerësohen me koeficientin 0.75 kundrejt kolegëve që kanë mbaruar në drejtimin ekonomik të cilët vlerësohen me koeficientin 1.</p> <p><i>Duke qenë ky program studimi me karakter jo vetëm ekonomik, por edhe në teknologji informacioni, gjykojmë se kriteret specifike të pranimit të studentëve në këtë program studimi, duhet të rishikohet më mirë nga institucioni për të qartësuar dhe vlerësuar më mirë studentët duke rritur cilësinë e studentëve që pranohen në këtë program.</i></p>





	[Dok.2. Statuti i UBT], [Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.50. Propozimi i Kritereve 2023-2024]
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Për programin e studimit Bachelor në teknologji Informacioni, janë paraqitur programet e lëndëve të cilat janë të klasifikuara në kategori A, B, C, D dhe E.</p> <p>Programi i lëndës jep informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulin/lëndën dhe semestrin kur zhvillohet, tipologjinë e modulit/lëndës njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti; kohëzgjatjen e modulit; kreditet ECTS; objektivat e modulit/lëndës; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; metodat e vlerësimit dhe literaturën.</p> <p>Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën totale për studentin, por pa e ndarë atë në ngarkesë në auditor dhe jashtë tij. Paraqitet gjithashtu përshkrimi i lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënies të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit dhe metodat e vlerësimit të njohurive. Megjithatë, institucioni në programet e lëndëve nuk ka caktuar qartë ndarjen në kredite të aktiviteteve didaktike formuese, por vetëm ngarkesën që ato paraqesin për studentin në total në auditor.</p> <p>Gjatë takimit me drejtuesin e njësisë bazë dhe atë të njësisë kryesore, u konfirmua se formati i syllabusit të përdorur është i unifikuar në nivel Universiteti Bujqësor dhe bazuar në formatin e parashikuar në shtojcën e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar.</p> <p>Megjithatë, nësi GVJ, gjykojmë se formati i syllabusit të paraqitur nga UBT, nuk zbërthen në formë të plotë shtojcën e parashikuar në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 i ndryshuar, e cila edhe pse nuk e shpreh qartazi, por nënkuptohet, në syllabuse duhet të paraqitet edhe ndarja në kredite për aktivitetet formues si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, detyra kursi etj., si dhe orët përkatëse të nevojshme në auditor dhe jashtë tij për të gjitha këto aktivitete.</p> <p>[Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në gjetjet gjatë vizitës në institucion, vërejmë se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhohet në përditësimin e vazhduar të programit të studimit që ofron. Në veçanti, në fund të vitit akademik, pedagogët e përfshirë në programin e studimit që po analizojmë, hartojnë një relacion përshkrues për të gjitha</p>






	<p>aspektet e mësimdhënies duke vënë në dukje problematika të hasura dhe sugjeruar zgjidhje për të ardhmen.</p> <p>Gjithashtu, institucioni përdor edhe raportet e vlerësimit të hartuara nga NJSBC-ja për përditësimin e programit të studimit.</p> <p>[Dok.24. Plan veprimi FEA 2022-2023], [Dok.26. Studim i tregut të punës përpara hapjes së programit], [Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT]</p>			
Konkluzione	<p><i>Në tërësi përmbajtja e këtij programi studimi është e plotë dhe në përputhje me objektivat formuese të studentëve.</i></p> <p><i>Dokumentacioni i mbajtur dhe azhornuar nga njësia bazë për këtë program studimi është i plotë, megjithatë ka nevojë për përmirësime administrative.</i></p> <p><i>Institucioni të hartojë syllabuset e lëndëve dhe planet mësimore të tillë që të paraqesin qartë ndarjen e të gjitha aktiviteteve formuese (leksione, seminare, laboratorë detyra/projekte kursi, etj.) në kredite përkatëse si dhe orët në auditor për secilin aktivitet.</i></p> <p><i>Sugjerojmë rishikimin e kriterëve të pranimit për të përthithur studentë me formim më specifik bachelor në fusha të përafërta me ato të këtij programi studimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	


Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve. Lëndët që përdorin punën laboratorike (edhe pse nuk është e specifikuar në syllabuset e lëndëve) ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre teknike dhe i bëjnë ata kandidatë shumë të mirë për në tregun e punës.</p> <p>Personeli akademik është i përkushtuar ndaj dhënies së njohurive praktike studentëve dhe kjo vërehet edhe në takimin me studentët, ku prej tyre u konfirmua impenjimi i stafit akademik në orë praktike si në laborator ashtu edhe në punime individuale të studentëve.</p>

	<p>Institucioni ka në funksion një sërë marrëveshjes institucionale, por kapacitetet e tyre nuk janë shfrytëzuar plotësisht në funksion të programit të studimit, aq më tepër që plani mësimor nuk parashiko një lëndë praktike.</p> <p>[Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësisimit profesional. Studentët e programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes”, janë vlerësuar pozitivisht në ambientet e punës ku kanë kryer praktikat profesionale apo rezultojnë të punësuar. Ky informacion është përdorur nga njësia bazë, si një masë për të vlerësuar kompetencat e fituara në programin e studimit të ofruar.</p> <p>Edhe pse ndarja në kredite ECTS është e tillë që lejon përçimin e njohurive kundrejt objektivave të vet programit të studimit, institucioni nuk ka detajuar ndarjen e orëve në auditor për çdo kredit ECTS për tipologjitë e aktiviteteve formuese si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë etj.</p> <p>[Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues të përcaktuar në këtë program studimi.</p> <p>Bazuar në planin mësimor, për këtë programi studimi janë parashikuar 540 orë leksione në auditor si dhe 540 orë seminare në auditor, duke rezultuar në një raport 50% me 50%. Gjithashtu, janë parashikuar edhe 12 kredite ECTS praktikë profesionale si dhe 18 kredite ECTS si punim diplome.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Mbështetur në strukturën e programit, në lëndët që përfshihen në të, raportet teorike praktike, ky program përputhet me profilin e studimit në menaxhimin e informacionit. Në të arrihet të trajtohen elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit.</p>

	[Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<p>Syllabuset e programit të studimit janë hartuar sipas një modeli të hartuar në nivel institucional, Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literatura bazë (e detyrueshme) dhe literature e rekomanduar ndihmëse, në ndonjë rast mungon viti i botimit të literaturës. Përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve koordinohet nga drejtuesit e departamenteve të cilët monitorojnë realizimin e lëndës/modulit në përputhje me syllabusin e miratuar. Literatura synohet të jetë e viteve të fundit.</p> <p>Megjithatë, vihet re se literatura e përdorur, nuk është çdo herë e viteve të fundit, në veçanti në syllabuse paraqiten literatura të detyrueshme dhe/ose e rekomanduar jo e 5 viteve të fundit disa janë të viteve 2002, 2008, 2009 etj.</p> <p><i>Sugjerojmë institucionin, që në lëndë të teknologjisë së informacionit, ku ndryshimet teknologjike janë shumë të shpejta, të përditësojë literaturën me edicione të viteve të fundit që paraqesin avancimet profesionale dhe shkencore në këtë fushë.</i></p> <p>[Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.28. Marrëveshje Bashkëpunimi me Institucionet Homologe dhe Aktorë Biznesi], [Dok.29. Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT], [Dok.36. Informacion nga Biblioteka Shkencore Mentor Përmeti]</p>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Informacioni në Agrobiznes, i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të dytë të studimeve (niveli i KSHK). Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve (edhe pse nuk janë të cituara në syllabuse) dhe praktikave profesionale. Studenti përvetëson njohuri shkencore, me aftësi praktike dhe menaxheriale.</p> <p>[Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21]</p>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në Menaxhim Informacioni në Agrobiznes i ofron studentëve njohuri dhe dije specifike të avancuara në këtë fushë.</p> <p>Megjithatë, përfundimi i këtij programi studimi, në tërësi, nuk mundëson vijimin e më tejshëm të studimeve në ciklin e tretë, doktorat.</p>




	[Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA]		
Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5



Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti i Matematikës dhe Informatikës në sajë të punës shumë vjeçare ka vendosur ura komunikimi të përhershme me aktore të biznesit në fushën e teknologjisë së informacionit si dhe të biznesit, në mënyre të përvitshme ai organizon takime ku diskuton për fushat dhe projektet ku mund të bashkëpunojnë, gjithashtu një vëmendje ky departament i kushton edhe përmirësimin të programeve të studimit. DMI gjithashtu ka kontakte edhe me disa universitete në Itali, Spanjë dhe Gjermani, nga të cilët ka marre edhe modelet e programeve të studimit. Gjithashtu UBT se bashku me FEA organizon në mënyre të përvitshme ditët e karrierës ku studentët kane mundësi të takojnë aktorët e biznesit e cila shikon një mundësi shumë e mirë për punësimin e tyre.</p> <p>Gjithashtu, UBT, ka qenë një nga universitetet e përfshirë në projektin GRADUA (<i>GRaduates Advancement and Development of University capacities in Albania</i>) ku është realizuar një portal komunikimi midis studentëve, universiteteve dhe aktorëve të biznesit dhe tregut të punës.</p> <p>[Dok.28. Marrëveshje Bashkëpunimi me Institucionet Homologe dhe Aktorë Biznesi], [Dok.29. Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT], [Dok.38. Raport Gjurmimi i Studentëve në UBT], [Dok.39. Raporti GRADUA - Vrojtimi i profilit të studentëve]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit.</p>	<p>Në zbatim të Ligjit të arsimit të lartë dhe Rregullores dhe Statutit të UBT, studentët marrin pjesë në disa organe kolegjiale si: Senati Akademik, Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës, etj. Gjithashtu studentët marrin pjesë në grupet e vlerësimit të brendshëm për vlerësimin e programeve të studimit dhe vlerësimin institucional. Studentët janë dhe pjesë e vlerësimit</p>

	<p>të mësimdhënies dhe personelit akademik, nëpërmjet pyetësorëve që organizohen periodikisht me ta.</p> <p>[Dok.38. Raport Gjurmimi i Studentëve në UBT], [Dok.39. Raporti GRADUA - Vrojtimi i profilit të studentëve]</p>		
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Siç rezulton nga evidencat përkatëse dhe nga vëzhgimi gjatë vizitës në institucion, Universiteti Bujqësor i Tiranës ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Në dokumentet zyrtare siç është Statuti i UBT-së parashikohen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen.</p> <p>Në rregulloren e sigurimit të cilësisë janë përcaktuar procedurat, afatet, instrumentet dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njëkohësisht, në ndihmë të këtij procesi përveç pyetësorëve periodikë, Departamenti i Matematikës dhe Informatikës harton dhe në mënyrë të përvitshme analizat vjetore të punës së tij dhe harton dhe panin e masave për përmirësime të mundshme ku në to është edhe analiza e nevojave të tregut të punës.</p> <p>[Dok.28. Marrëveshje Bashkëpunimi me Institucionet Homologe dhe Aktorë Biznesi], [Dok.29. Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBTDok.39. Raporti GRADUA - Vrojtimi i profilit të studentëve], [Dok.50. Propozimi i Kritereve 2023-2024], [Dok.64. Manuali i Cilësisë UBT]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UBT nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve të biznesit, në mbledhje e të dhënave si bazë analize periodike në rishikimin e programeve të studimit në tërësi me synim përmirësimin në tërësi të programeve të studimit që ofron.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit, Master Profesional në Menaxhim Informacioni në Agrobiznes, është në përputhje me objektivat strategjike të Universitetit Bujqësor të Tiranës, i cili në këtë program ka gërshetuar zhvillimet e vrullshme në teknologjinë e informacionit me ato të boshteve prioritare</p>

	<p>kombëtare sikurse është zhvillimi i bujqësisë, agrobiznesi dhe i të gjithë zinxhirit të lidhur me to.</p> <p>Ky program studimi është i orientuar drejt praktikës ku vërehet një organizim 50% me 50% i orëve të leksioneve me ato të seminareve në auditor.</p> <p>[Dok.2. Statuti i UBT], [Dok.3. Plani Strategjik UBT_2016-2025], [Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.5. Rregullore e njësisë kryesore FEA], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.7. Rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ], [Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës, dhe në veçanti njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, respekton fushën e ekspertizës dhe kualifikimin e stafit akademik. Në veçanti, stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, zhvillon lëndë apo module në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës.</p> <p>Vlerësojmë se në tërësi, institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike, duke u bazuar edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018, “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë” dhe Ligjin Nr.9887 datë 10.03.20008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</p> <p>[Dok.2. Statuti i UBT], [Dok.3. Plani Strategjik UBT_2016-2025], [Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.5. Rregullore e njësisë kryesore FEA], [Dok.16. CV e Stafit Akademik të Programit të Studimit MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimi, Master Profesional në Menaxhim Informacioni në Agrobiznes, është i orientuar kryesisht drejt zbatimit praktik/profesional të njohurive në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ato të ekonomisë. Si i tillë, orienton studentët drejtë zhvillimit të projekteve të zbatuara në fushën e agrobiznesit në tërësi, çka përfshinë edhe pjesë kërkimore. Megjithatë nuk ka një motivim të mirëfilltë drejt fushave kërkimore shkencore, por kjo nuk është në objektivin e këtij programi.</p> <p>[Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21]</p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës, është një institucion publik i arsimit të lartë dhe zhvillon aktivitetin e tij në përputhje me Ligjin 80/2015 për arsimin e lartë. Si i tillë, institucioni administron buxhetin në tërësi, duke planifikuar ndarje të tij në njësi kryesore dhe ato bazë.</p>

	<p>Planifikimi i buxhetit zhvillohet pranë njësive bazë, të cilat hartojnë nevojat për të gjithë aktivitetet ekonomike si dhe kriteret për bazë materiale, laboratorike etj. Në planifikimin e buxhetit, institucioni mbështet njësinë bazë në zhvillimin e saj strategjik, apo edhe në mbështetje në bazë infrastrukture brenda njësisë kryesore.</p> <p>[Dok.24. Plan veprimi FEA 2022-2023], [Dok.25. Relacion për realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimi 2022 FEA], [Dok.65. Rregullore e Bordit të Administrimit të UBT], [Dok.66. Zyra Erasmus, Drejtoria e Projekteve dhe Zhvillimit UBT], [Dok.68. Rregullore mbi hartimin dhe menaxhimin e projekteve të UBT], [Dok.71. Plani Strategjik i Kërkimit 2016-2025, UBT]</p>								
Konkluzione	<i>Programi i studimi, Master Profesional në Menaxhim Informacioni në Agrobiznes, është i orientuar kryesisht drejt zbatimit praktik/profesional të njohurive në fushën e teknologjisë së informacionit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Njësia bazë, departamenti i Matematikës dhe Informatikës është i organizuar në tre grupe mësimore/kërkimore ku janë grupuar stafi akademik në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës. Kjo në zbatim të udhëzimeve zbatuese të ligjit 80/2015 për arsimin e larët si dhe në statutin dhe rregulloren e njësive kryesore në UBT.</p> <p>Departamenti mbështet avancimin akademik të stafit të tij, edhe pse për këtë program studimi, objektivat e tij formuese janë të një karakteri profesional.</p> <p>[Dok.2. Statuti i UBT], [Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.5. Rregullore e njësisë kryesore FEA], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës në tërësi, dhe në veçanti Departamenti i Matematikës dhe Informatikës, angazhohen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare si pjesë e UBT. Angazhim i sanksionuar edhe në rregulloret institucionale por edhe në fushën e tyre të ekspertizës. Projekte që janë me karakter të zbatuar apo me karakter kërkimor-shkencor.</p> <p>Në tërësi, institucioni angazhon personelin akademik si dhe studentët në projektet që është i përfshirë, sipas fushës së tyre të ekspertizës. Në rastin</p>

	<p>konkret të studentëve të këtij programi studimi, duke qenë ai i një karakteri profesional, nuk janë përfshirë në projekte të zhvilluar nga UBT.</p> <p>[Dok.7. Rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ], [Dok.25. Relacion për realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimi 2022 FEA], [Dok.68. Rregullore mbi hartimin dhe menaxhimin e projekteve të UBT], [Dok.71. Plani Strategjik i Kërkimit 2016-2025, UBT]</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësi përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>UBT në tërësi, njësitë kryesore përbërëse dhe ato bazë, janë të angazhuar në organizimin e konferencave si organizator apo bashkë organizator. Stafi akademik është i angazhuar në pjesëmarrje në konferenca ku paraqesin avancimet e tyre në fushën e ekspertizës së kërkimit shkencor. Informacione rreth konferencave të organizuara nga UBT, paraqiten edhe në faqen ueb të institucionit (https://www.ubt.edu.al/sq/konferenca-shkencore)</p> <p>UBT, përveçse motivimin dhe mbështetjen në organizimin e konferencave, është edhe e angazhuar në botime shkencore, me dy revista “<i>Albanian Journal of Agricultural Sciences (AJAS)</i>, ISSN: 2218-2020” si dhe “<i>Journal of Economy and Agribusiness (JEA)</i>, ISSN: 2223-7658”.</p> <p>Stafi i njësisë bazë, është i angazhuar edhe në zhvillimin e udhëzuesve të ndryshëm për përdorimin e metodave të teknologjisë së informacionit në ndihmë të procesit të mësimdhënies.</p> <p>[Dok.30. Pjesëmarrja e Stafit në Projekte], [Dok.31. Trajnimet e Stafit të FEA], [Dok.33. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative “GOOGLE APPS”], [Dok.34. Manual Klase Virtuale ZOOM], [Dok.35. Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora], [Dok.71. Plani Strategjik i Kërkimit 2016-2025, UBT]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit, ka objektiva të qartë në formimin e studentëve, objektiva të përcaktuara edhe nga studimi i tregut të zhvilluar nga njësi bazë, përgjegjëse për këtë program. Më konkretisht, ky program studimi, synon aftësimin e studentëve me njohuri ekonomike në menaxhim dhe siguri të dhënave, rrjetave dhe sistemeve të informacionit si dhe njohje e mirë e programeve kompjuterike të dedikuara për bizneset.</p> <p>Megjithatë, formimi i tyre, nuk është specifik në fushën e agrobiznesit, por është më i përgjithshëm në fushën e menaxhimit të informacionit.</p> <p>Sikurse vërehet edhe nga syllabuset e lëndëve në fushën e teknologjisë së informacionit, ato janë me formim të përgjithshëm, dhe jo specifik për agrobiznes.</p> <p>Studentët e këtij programi studimi, marrin një formim konkurrues për tregun kombëtar të punës, por mund të mos e gjejë veten konkurrues në tregun ndërkombëtar. Kjo pasi në tregun ndërkombëtar të punës, njohuritë</p>

	<p>e përfituara në këtë program studimi, krahasohen dhe tejkalohen nga ato specifike në fushën e teknologjisë së informacionit.</p> <p>Formimi i studentëve në këtë program studimi, me një karakter pjesërisht menaxherial/ekonomik dhe pjesërisht në teknologjinë e informacioni/informatikë, është koherent me programe të ngjashme studimi të ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, por nuk gjen një praktikë ndërkombëtare të ngjashme.</p> <p>[Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.26. Studim i tregut të punës përpara hapjes së programit]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Studentët e diplomuar në këtë program studimi, mund të ushtrojnë profesionin e tyre pa patur nevojë për regjistrim apo anëtarësim në urdhër profesional. Në veçanti, për formim në fushën e teknologjisë së informacionit, aktualisht nuk ka shoqata profesionale apo urdhër që të rregullojnë fushën e zbatimit të këtij profesioni. Në fushën e menaxhimit dhe ekonomisë ka organizata dhe urdhër profesional që rregullojnë këtë sektor. Megjithatë formimi i studentëve të këtij programi studimi, është pjesërisht menaxherial/ekonomik, ata nuk karakterizohen të plotë në fushën e ekonomisë ku mund të rregullohen nga shoqatat profesionale përkatëse.</p> <p>Studentët e këtij programi studimi, pajisen me diplomë të nivelit të dytë, Master Profesional në Menaxhim Informacioni në Agrobiznes.</p> <p>Megjithatë, institucioni bashkëpunon me institucione private apo shtetërore, nga të cilat vlerëson edhe rekomandime apo nevoja në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit që ofron. Kjo vërehet edhe në studimin e tregut të punës i zhvilluar përpara hapjes së këtij programi.</p> <p>[Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.26. Studim i tregut të punës përpara hapjes së programit], [Dok.29. Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT]</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Programi i studimi i nivelit të dytë, Master profesional në Menaxhim Informacioni në Agrobiznes, si dhe diploma përkatëse e lëshuar në përfundim të tij, nuk përkon me profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimi bazohet në një studim tregu dhe është ndërtuar në bazë të nevojave të vëna në dukje nga ky studim.</i></p>


	<i>Formimi i studentëve në këtë program, është me karakter profesional, i dyzuar midis menaxhimit dhe teknologjisë së informacionit duke e gjetur veten në tregun kombëtar të punës dhe jo plotësisht në atë ndërkombëtar</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>GVJ konstatoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë një kombinim i metodave tradicionale me ato bashkëkohore të vlerësimit përfundimtar të studentit. Vlerësimi nga pikëpamja akademike e mësimi, projekteve, detyrave, praktikave, seminarëve dhe punëve të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse të orës së performuar në auditor. Vlera e krediteve të një lënde përbëhet nga numri total i orëve javore të parashikuara për lëndë. Gjatë një viti akademik plotësohen të paktën 60 Kredite ECTS. Studentët vlerësohen mbi bazën e provimeve të ndërmjetme; provimeve finale; detyrave; prezantimeve dhe projekteve. Metodatat e vlerësimit janë të shprehura qartë në syllabusin e çdo lënde dhe çdo lektor organizon përqindjen e vlerësimit për secilën pjesë. Llojet e vlerësimit janë: detyrat, kolekiomet, kuizet, projektet, pjesëmarrja në mësim, provimet e ndërmjetme dhe provimet finale.</p> <p>Megjithatë, në syllabusin e lëndëve, por edhe në planin mësimor, institucioni ka parashikuar numrin total të krediteve ECTS por jo ndarjen e tyre në aktivitete formuese si Leksione, Ushtrime/Seminare, laboratorë, detyra/Projekte kursi, etj.</p> <p>Në planin mësimor janë të parashikuara vetëm dy aktivitete didaktike formuese, Leksione dhe Seminare. Nuk ka të parashikuara aktivitete didaktike si Laborator apo detyra/projekte kursi.</p>

	<p>Në syllabuset e lëndëve, është paraqitur si informacion shtesë, informacioni që citojmë:</p> <p><i>[...studentët do të kenë mundësinë e zbatimit praktik të lëndëve në laboratorët e degës “Informatikë Biznesi”. Kjo do t’ju shërbejë për vënin në zbatim të të gjitha koncepteve teorike të marra gjatë lëndës...]</i></p> <p>Gjithashtu, në rregulloren e programi të studimit, në veçanti neni 27, parashikohet që studentët e këtij programi studimi duhet të frekuentojnë së paku 80% të orëve laboratorike. Por në planin mësimor, nuk ka të përcaktuara orë laboratorike për asnjë nga lëndët e këtij programi.</p> <p>Pavarësisht, mos paraqitjes në planin mësimor dhe në syllabuset përkatëse, sidomos për aktivitetet laboratorike, zhvillimi i këtij programi studimi kryesisht në fundjavë apo në orar mbas dite, si dhe numri i ulët i studentëve të regjistruar, ka mundësuar përdorimin e ambienteve laboratorike të institucionit për zhvillimin e aktivitetet të seminareve ku studentët kanë praktikuar në ambient laboratorik njohuritë e tyre.</p> <p><i>Ne si GVJ, sugjerojmë institucionin të hartojë planin mësimor dhe syllabuset përkatëse që të detajojnë të gjitha aktivitetet didaktike si dhe peshën e tyre në auditor dhe në vlerësim.</i></p> <p>[Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik monitoron me kujdes rastet specifike dhe gjithmonë përpiqet të identifikojë kërkesat e studentëve që mund të kenë nevojë. I gjithë personeli akademik dhe ndihmës akademik i njësisë bazë është i gatshëm për të ndihmuar studentët si në aktivitetet e tyre didaktike, ashtu edhe në zhvillimin e projekteve individuale. Për këtë qëllim, vendosin në dispozicion edhe laboratorët dhe ambientet e institucionit.</p> <p>Gjithashtu, për të paraqitur në një këndvështrim plotësues për studentët, njësia bazë dhe ajo kryesore marrin pjesë edhe në aktivitete shkencore si konferenca apo ore të hapura ku studentët ftohen të marrin pjesë. Pavarësisht se studentët e këtij programi studimi nuk janë të angazhuar në aktivitete kërkimore shkencore, duke qenë ky një program studimi me karakter profesional.</p> <p>[Dok.33. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative “GOOGLE APPS”], [Dok.34. Manual Klase Virtuale ZOOM], [Dok.35. Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora]</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni demonstroi se mbështet personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike. Për këtë qëllim mbështet organizimin e aktiviteteve shkencore si konferenca të organizuara nga institucioni apo në bashkëpunim me institucione të tjera. Gjithashtu stafi akademik këshillohet të marrë pjesë në aktivitete të tjera shkencore, por në këto raste, mbështetja ekonomike e institucionit jo gjithmonë është e mjaftueshme apo në nivelin e kërkuar për këtë lloj aktiviteti.</p> <p>Brenda institucionit, stafi akademik më me përvojë përpigjet për të motivuar dhe trajnuar stafin më të ri, apo atë që nuk është i fushës së teknologjisë së informacionit duke hartuar manuale praktike për përdorimin e teknikave dhe metodave të reja në mësimdhënie.</p> <p>[Dok.33. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative “GOOGLE APPS”], [Dok.34. Manual Klase Virtuale ZOOM], [Dok.35. Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Programi i studimit mbulohet i gjithi nga personeli akademik i institucionit në tërësi dhe në veçanti nga stafi i njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi. Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është i kualifikuar në fushën e lëndëve që mbulon si dhe me një përvojë relativisht të gjatë në mësimdhënie.</p> <p>Bazuar në DVV dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion FSHN, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies be mënyre të vazhdueshme, në të cilën mbështet nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnimet dhe pjesëmarrjet në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë.</p> <p>Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se personeli akademik përdor metoda interaktive duke i bërë tërheqëse orët e mësimin. Këto metoda përfshijnë simulime, video, detyrë kurse, diskutime, prezantime etj.</p> <p>Përdorimi i infrastrukturës laboratorike në mësimdhënie të vënë në dispozicion nga njësia kryesore, si dhe aktivitetet praktike/laboratorike e kanë rritur efektivitetin e metodave dhe interaktivitetin në mësimdhënie.</p> <p>[Dok.16. CV e Stafit Akademik të Programit të Studimit MP_MIA], [Dok.17. Pedagoget e Ftuar në FEA për V.A. 2022-2023], [Dok.18. CV e stafit ndihmës akademik]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit,</p>	<p>GVJ konstaton se një nga objektivat strategjik të Universitetit të Tiranës është “Cilësia dhe performanca Akademike”. Nga shqyrtimi i</p>

<p>vlërëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>dokumentacionit GVJ konstaton se strukturat përgjegjëse kanë zhvilluar mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p>Bazuar në DVV dhe informacioni përgjatë vizitës në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit konstatohet se njësia përgjegjëse për monitorimin në mënyrë periodike të aftësive të mësimdhënies se personelit akademik dhe ndihmës akademik është njësia bazë. Drejtuesi i njësisë bazë analizon në fund të çdo semestri performancën e çdo anëtari të departamentit dhe me pas kontakton çdo anëtar për të shprehur gjetjet dhe mundësitë për përmirësim të mëtejshëm. Nga ana tjetër UBT ka zhvilluar të gjitha mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, kështu janë rregulluar me rregulloret përkatëse zyrat për monitorimin e brendshëm të cilësisë dhe raportimi përkatës pranë njësive kryesore dhe bazë.</p> <p>UBT përfshin studentët në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies duke ju dhënë mundësi atyre të plotësojnë pyetësorë periodikë për vlerësimin e të gjithë aspekteve akademike dhe administrative të jetës studentore.</p> <p>[Dok.37. Qendra e Karrierës dhe ALUMNI, UBT], [Dok.32.1. Pyetësori i studentëve online UBT], [Dok.32.2. Format Pyetësori i studentëve FEA], [Dok.38. Raport Gjurmimi i Studentëve në UBT], [Dok.39. Raporti GRADUA - Vrojtimi i profilit të studentëve]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>GVJ, në bazë të dokumenteve konstaton se rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. NJBSC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuar. Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për përmirësimin e mësimdhënies ne auditor te personelit akademik, nëpërmjet trajnimeve te vazhdueshme ku promovohen shembuj të praktikave të mira. UBT është angazhuar në disa projekte ndërkombëtare dhe ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare me të cilat inkurajon dhe stimulon stafin të marre pjese në programe shkëmbimi siç janë Erasmus+ KA1 dhe KA2, ku një nga përfitimet kryesore është përmirësimi i aftësive të personelit akademik në mësimdhënie.</p> <p>[Dok.9. Rregullore DVBS], [Dok.24. Plan veprimi FEA 2022-2023]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UBT ka të ngritur mekanizma për monitorimin e brendshëm të cilësisë, mekanizma të cilët përfshijnë edhe studentët si një hallkë e rëndësishme e procesit të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë.</i></p>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2



Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit, në veçanti neni 29 dhe neni 30, sistemi i vlerësimit. Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm të cilat janë specifike në varësi të tipit të lëndës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 0-15% niveli i diskutimit në seminare - 0-30% detyrë / projekt kursi - 0-50% provimi i ndërmjetëm - 0-100% provimi përfundimtar <p>[Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21]</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe me stafin akademik, GVJ konstaton se në DMI, për programet që mbulon, informon studentët mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive dhe dijeve.</p> <p>Format e kontrollit të dijeve janë të ndryshme, bazuar në specifikat e secilës lëndë. Forma të cilat janë të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve në javën e parë të procesit mësimor. Studentët informohen rregullisht edhe mbi planet mësimore dhe kurrikulën e programit të studimit, këtu një rol të rëndësishëm luajnë edhe kujdestaret e grupeve si dhe koordinatori i programit të studimit. Informacion të hollësishëm studentët përveç informimit nga pedagogu i lëndës gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve, ku në varësi të natyrës së lëndës, nga çdo pedagog, në përputhje me rëndësinë që ka aspekti aplikativ përcaktohet pesha e secilit element në vlerësimin përfundimtar të cilat i bëhen të ditura studentit. I gjithë informacioni</p>




	mbi përmbajtjen e programit të studimit gjendej lehtësisht në ambientet e njësisë bazë, sikurse edhe në faqen zyrtare UBT-së. [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]		
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lëndë janë: Provimi i ndërmjetëm [0-50%], Niveli i pjesëmarrjes në seminare [0-10%], Detyra e kursit (projekte) [0-30%] Provimit përfundimtar [0-100%]. Në takimin me studentët na konfirmuan që përfshirja e këtyre formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin format e veçanta të aftësive dhe talenteve të tyre, dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor. [Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]		
Konkluzione	<i>UBT ka të specifikuar qartë në rregulloren e programit të studimit si dhe në syllabuset e lëndëve, format dhe modalitetet e testimit të njohurive.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në DVV, syllabuset e lëndëve, vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare dhe laboratorë, detyrave të kursit etj. sipas komponentëve të përcaktuar në syllabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës. Kryesisht kontrollet dhe provimet e ndërmjetme realizoheshin pas mesit të secilit semestër. [Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të	Testimi dhe vlerësimi në DMI është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale me mjetet elektronike (hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave të kursit/projekteve). Sipas RVB në disa lëndë



<p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>është aplikuar testimi online duke përdorur platformën Google sidomos gjatë periudhës së diktuar nga përhapja e virusit Sars-Cov2.</p> <p>[Dok.33. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative “GOOGLE APPS”], [Dok.34. Manual Klase Virtuale ZOOM], [Dok.35. Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora]</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve të përfituara nga studentët për secilën lëndë, bazohet në kriteret dhe modalitete të shprehura qartë në rregulloren e programit të studimit dhe më në detaje në syllabusin e lëndës. Modalitete të cilat janë të miratuara në nivel institucional.</p> <p>[Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e institucionit. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen.</p> <p>Studentët kanë mundësinë e rishikimit të vlerësimit dhe të qartësohen nga pedagogu i lëndës si për vlerësimin ashtu edhe për mënyrën e përmirësimit të dijeve në vijim.</p> <p>[Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht të punimet e diplomave) të jenë autentike.</p> <p>Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar manualit të cilësisë në UBT si dhe Rregullores së Këshillit të Etikës.</p>



	[Dok.64. Manuali i Cilësisë UBT], [Dok.70. Rregullore e Këshillit të Etikës UBT]
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulet kaluese është 5, sikurse paraqitet në rregulloren institucionale në veçanti në Kreun IX, neni 56 e në vijim. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi informatik në rast të zhvillimit të tyre në platformën Teams, ose edhe me komunikim verbal dhe individual, në departament. Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes si dhe datën kur studentët mund të paraqiten për tu qartësuar rreth vlerësimit. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në departament.</p> <p>Studentët informohen për vlerësimin edhe në sistemin elektronik të UBT i cili aktualisht është sistemi PITAGORA e më parë ka qenë sistemi ESSE3, të dy të organizuar në bashkëpunim me RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar).</p> <p>Gjate vitit pedagogët janë të lirë të alternojnë metodat kontrolluese dhe vlerësuese të cilat përfshijnë kontroll të vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje alternative, kuize, prezantime ne grup ose individuale, etj.</p> <p>[Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA]</p>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se në rregulloren e universitetit përcaktohet e drejta e studentit për ankimimin e rezultateve të provimit. Në veçanti në nenin 66 të kësaj rregullore, citojmë [<i>...Pas shpalljes së rezultateve, hedhjes së tyre në sistem, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve (48 orë)...</i>]</p> <p>GVJ konstaton se në rregulloren e universitetit përcaktohet se ankimimi i studentit i dërgohet Dekanit brenda 24 orësh nga marrja e vlerësimit. Dekani nga marrja dijani për ankesën mund të thërrasin për sqarim drejtuesin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit si dhe komisionin e provimit.</p> <p>[Dok.2. Statuti i UBT], [Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA]</p>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë	<p>Rregullorja e UBT, përkatësisht nenet 65 dhe 66 kanë të përcaktuara të gjitha detajet mbi informimin e studentëve për vlerësimin, kohën dhe procedurat për ankimimin e vlerësimit. Studenti ka të drejtë të ankohet për mos plotësimin e rregullave të provimit dhe të vlerësimit të tij.</p>



transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Kërkesa për ankimi shqyrtohet nga komisioni fillestar apo komisionet e tjera të ngritura, duke respektuar rregulloren e provimeve dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në UBT. [Dok.2. Statuti i UBT], [Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA]		
Konkluzione	<i>UBT ka të hartuar qartë dhe në detaje në rregulloret institucionale të gjitha procedurat për vlerësimin e dijeve, shpalljen e rezultateve si dhe shqyrtimin e ankimimeve apo nevojave për qartësime të studentëve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lende teorike dhe praktike në fushën e teknologjisë së informacionit, IT, praktiken profesionale dhe diplomën. Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lëndën përkatëse. Departamenti ofron shërbime shtese krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime apo leksione të hapura. Staf i akademik përfshin studentet në veprimtari jashtë kurrikulare. Gjithashtu, shkëmbimet e studenteve ndihmojnë në përthithjen e aftësive në fushën e IT, gjuhëve të programimit, softwarëve të ndryshëm etj. [Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit garanton zhvillimin e veçantë në fushën e teknologjisë së informacionit si dhe e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit. Për sa më sipër, në planin mësimor të këtij programi studimi, janë të parashikuara zhvillimi i lëndëve karakterizuese në teknologjinë e informacionit dhe janë parashikuar gjithashtu edhe lëndë me karakter të menaxherial dhe financiar si “Menaxhimi i projekteve”, “Financa ndërkombëtare” etj.

	[Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Bazuar në dokumentet e dosjes së vetëvlerësimit dhe në veçanti rregullores së programit të studimit dhe atyre institucionale, konstatohet se në fund të çdo semestri, kompetencat dhe aftësitë e studentëve, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e secilës lëndë, analizohen dhe rishikohen. Kujdes i veçantë u kushtohet lëndëve që janë në vijimësi të lëndëve të tjera në semestrat pasardhës dhe mbahet komunikim midis lektorëve të lëndëve që janë të ndërlidhura. [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA]
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Institucioni garanton qasje në laboratorët e informatikës për studentët e këtij programi studimi. Edhe pse në plan-programet e lëndëve nuk është e ndarë qartë aktiviteti laboratorik nga ai i ushtrimeve/seminareve, gjatë takimit në institucion dhe në veçanti me studentët e këtij programi studimi u konfirmua zhvillimi i laboratorëve për të gjitha lëndët e teknologjisë së informacionit. Edhe nga stafi akademik, u vu në dukje, se zhvillimi i seanceve laboratorike janë të gërshtuara me ato teorike (seminare/ushtrime) të cilat studenti motivohet ti zbatojë praktikisht në aktivitet laboratorik. GVJ, gjatë takimit me stafin akademik konstaton se studentët inkurajohen për të punuar në grup në zgjidhjen e detyrave apo projekteve të kursit, gjatë procesit mësimor, në praktika, laboratorë etj. Kjo punë realizohet nën drejtimin e pedagogut udhëheqës apo të lëndës. GVJ konstaton se në njësinë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim studentët-pedagog. Aktivitetet kërkimore shkencore të zhvilluara nga stafi akademik i njësisë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, është kryesisht i bazuar në punë individuale dhe me mbështetje të pjesshme financiare apo logjistike nga ana e institucionit. [Dok.10.1. Dosja e programit të studimit MP_MIA 22-23], [Dok.10.2. Dosja e programit të studimit MP_MIA 21-22], [Dok.10.3. Dosja e programit të studimit MP_MIA 20-21], [Dok.15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA], [Dok.16. CV e Stafit Akademik të Programit të Studimit MP_MIA], [Dok.17. Pedagoget e Ftuar në FEA për V.A. 2022-2023], [Dok.18. CV e stafit ndihmës akademik]






<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i njësisë bazë angazhohet në aktivitete shkencore, në konferenca, simpoziume dhe workshope, si dhe mundëson zhvillimin e orëve të hapura nga pedagog të ftuar pranë këtij institucioni</p> <p>Stafi i njësisë bazë, i angazhuar në këtë program studimi, organizon diskutime me studentet për temat e diplomës, për mundësitë e punësimit të tyre, u prezanton pjesëmarrjen e departamentit në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon grupe pune studimore me pjesëmarrjen e studentëve.</p> <p>[Dok.16. CV e Stafit Akademik të Programit të Studimit MP_MIA], [Dok.17. Pedagoget e Ftuar në FEA për V.A. 2022-2023], [Dok.18. CV e stafit ndihmës akademik]</p>		
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Stafi akademik i njësisë bazë mbështet studentët për zhvillimin e ideve të tyre në ambientet e institucionit duke vënë në dispozicion të gjithë bazën laboratorike. Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi u vu në dukje mbështetja dhe ndihma e stafit akademik për studentët në zhvillimin e projekteve.</p> <p>Megjithatë, nuk vihet re një mbështetje financiare e institucionit për rritjen e studimeve të avancuara kërkimore si për stafin ashtu edhe për studentët.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit aftëson studentë në fushën e teknologjisë së informacionit në tërësi si dhe i pajis ata me njohuri menaxheriale. Megjithatë, aplikimi në agrobiznes, zë një pjesë të vogël të këtij programi.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni parashikon procesin e diplomimit të studentëve në tërësi në aktet e brendshme rregullatore. Rregullorja e njësisë kryesore dhe ajo e njësisë bazë paraqesin qartë procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në këtë program studimi</p> <p>[Dok.42. Template për temën e diplomës], [Dok.43. 1. Fusha Kërkimi dhe Tema Master], [Dok.43. 3 Format Kërkese për Temë Diplome], [Dok.43. List pyetje orientimi për provim formimi]</p>

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Gjate takimit me studentët u evidentua se ato asistoheshin nga koordinatori i programit të studimit por edhe nga stafi akademik në takime informuese që zhvilloheshin përgjatë vitit të dytë. Studentët informohen rreth procedurave të zhvillimit të praktikave profesionale si dhe ato që duhen ndjekur për hartimin e punimit të diplomës apo provimin përfundimtar.</p> <p>Takimet me koordinatorin e programit në veçanti, i ndihmojnë studentët të kuptojnë edhe më mirë mënyrën e zhvillimit të punimit/provimit si dhe mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Fondi i pyetjeve së bashku me udhëzuesin e punimit të diplomës janë në dispozicion të studentëve si në zyrën e informimit të studentit pranë njësisë kryesore dhe po ashtu edhe në platformën elektronike të përdorur nga institucioni.</p> <p>Në rastin e diplomës, çdo pedagog që caktohet udhëheqës i temës së diplomës punon me studentin e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur duke u rekomanduar të gjitha materialet që mund të ndihmojnë studentin të realizojë punimin e diplomës.</p> <p>[Dok.42. Template për temën e diplomës], [Dok.43. 1. Fusha Kërkimi dhe Tema Master], [Dok.43. 3 Format Kërkese për Temë Diplome], [Dok.43. List pyetje orientimi për provim formimi]</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në rregulloret e institucionit, GVJ konstaton se Teza e Provimit të përgjithshëm përfundimtar është e përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së lëndës (krediteve) në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera.</p> <p>Komisioni i provimit përgatit tezen për provimin e përgjithshëm përfundimtarë bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.</p> <p>Megjithatë, u vu re gjatë takimit me studentët e këtij programi, se në tërësi, studentët kanë zhvilluar punim diplome për përfundimin e këtij cikli studimi.</p> <p>[Dok.43. List pyetje orientimi për provim formimi]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit personeli akademik i departamentit dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e tezës së diplomës. Në këtë proces angazhohet jo vetëm udhëheqësi i punimit të temës së diplomës por edhe pedagogë të tjerë, specialistë të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor, në të përfshihet edhe stafi ndihmës akademik.</p>




<p>miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ konstaton se udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve dhe konkluzioneve, përpunimin e tyre, si dhe paraqitjen dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve, origjinalitetin e tyre dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>[Dok.42. Template për temën e diplomës], [Dok.43. 1. Fusha Kërkimi dhe Tema Master], [Dok.43. 3 Format Kërkese për Temë Diplome],</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi përfundimtar ose projekti i diplomës vlerësohet me notë, nga komisioni i provimit ose i mbrojtjes së diplomës.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar është një mesatare e vlerësimeve të pavarura të anëtarëve të komisionit pas prezantimit të temës nga kandidati dhe pas përgjigjeve të pyetjeve të ngritura nga komisioni. Nota i komunikohet studentit në prani të komisionit nga kryetari i tij.</p> <p>Në rastin e provimit përfundimtar, nota del pas vlerësimit të çdo tematike nga anëtari i komisionit përgjegjës për grup-pyetje brenda fushës së tij të ekspertizës.</p> <p>[Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT]</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 120 kredite ECTS, zyrat administrative përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Sekretaria mësimore pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e saj sipas formateve të aprovuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Diploma lëshohet vetëm një herë, dhe regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.</p> <p>[Dok.4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok.21. Regjistrim i Formës së Diplomes + Numër Unik Identifikimi MP_MIA], [Dok.22. Model Diplome MP_MIA], [Dok.23. Model Diploma Supplement MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës, përveç sistemit elektronik në përdorim nga sekretaria mësimore (ESSE3 dikur dhe Pitagora tashmë), në funksion të qëllimit të saj administrativ, ruan dhe plotëson dokumentacionin themeltar të kërkuar nga kuadri ligjor në fuqi. Në veçanti, institucioni plotëson dhe ruan tre regjistra kryesor me të dhëna të plota të studentëve, arritjet e tyre akademike deri në diplomim.</p> <p>Regjistrat e më sipërm, janë sipas formatit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe plotësimi i tyre realizohet në përputhje të udhëzimeve përkatëse të detajuar nga po kjo ministri.</p>

	<p>Institucioni ka detyrimin ligjor, që në përfundim të kohës së parashikuar të mbajtjes së këtyre regjistrave pranë institucionit, ti depozitojë ato pranë arkivave të shtetit, duke mbajtur pranë institucionit, një kopje të njehsuar me origjinalin. Nga ku mund të nxirret çdo informacion i nevojshëm për studentët që kanë frekuentuar këtë institucion.</p> <p>[Dok.51. Lista e Shërbimeve në ZSS]</p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni ka përcaktuar qartë rregulloret për diplomimin e studentëve (me diplomë ose provim përfundimtar), përfshirë këtu edhe mënyrën e vlerësimit.</i></p> <p><i>Institucioni mban dhe pajis studentët me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, duke përfshirë diplomën sipas formatit të miratuar dhe me numër unik, regjistrat themeltar, atë të avancimit akademik dhe atë të diplomimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë bazë, lëndë karakterizuese dhe plotësuese, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të manaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit si dhe teknologjisë së informacionit.</p> <p>Modulet apo lëndët e zhvilluara në këtë program studimi, edhe pse nuk kanë të paraqitur qartë në syllabus, ato zhvillojnë aktivitete laboratorike nën zërin e “seminareve”. Institucioni garanton laboratorët e informatikës të cilët kanë kapacitete të mjaftueshme për numrin e studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Ndërsa praktika profesionale zhvillohet pranë kompanive apo institucioneve publike me të cilat institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>[Dok.27. Kapacitete dhe të dhëna për infrastrukturën FEA]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe</p>	<p>Bashkëpunimi i Universitetit Bujqësor të Tiranës me institucione homologe si dhe me aktorë të biznesit, mundësojnë për studentët e këtij</p>


<p>teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>programi studimi, ambiente stimuluese për zhvillimin e praktikave mësimore profesionale.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik dhe me studentët, u vu re se studentët e këtij programi studimi, zhvillojnë praktikën profesionale në kompani kryesisht të lidhura me fushën e teknologjisë së informacionit dhe më pak në ato të lidhura me fushën e agrobiznesit, ku duhej të ishte edhe fokusi i zbatimit të këtyre njohurive.</p> <p>[Dok.28. Marrëveshje Bashkëpunimi me Institucionet Homologe dhe Aktorë Biznesi], [Dok.29. Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT]</p>
--	--

<p>Kriteri 3. Praktikë profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Praktika profesionale, sipas planit mësimor, është një aktivitet formues i vlerësuar me 12 kredite ECTS, dhe vlerësohet me notë.</p> <p>Studenti i cili ka zhvilluar praktikën profesionale pranë një institucioni pritës, dorëzon në njësinë bazë një dokument të plotësuar nga institucioni ku ka zhvilluar praktikën, e cila paraqet një vlerësim të studentit për këtë aktivitet. Në përfundim të praktikës, studentit prezanton para jurisë të ngritur në departament, aktivitetin e zhvilluar prej tij gjatë praktikës. Komisioni, mbasi shqyrton relacionin e praktikës të plotësuar nga institucioni pritës, si dhe paraqitjes së studentit, e vlerëson këtë të fundit me notë.</p> <p>[Dok.45. Kërkesa dhe Kontrata për Praktikë Profesionale në MP_MIA], [Dok.46. Trajnimet e Studenteve të FEA]</p>
---	---

<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka të paraqitur në rregulloret e tij të gjithë procedurën e detajuar të fillimit, zhvillimit dhe vlerësimit të praktikës profesionale të zhvilluar në funksion të fitimit të njohurive nga studentët.</i></p>
---------------------------	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X




IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ referuar dokumentacionit të dosjes së vlerësimit si dhe nga vizita në institucion, konstaton se UBT, ruan të dhëna të plota për stafin akademik si dhe atë ndihmës-akademik dhe administrativ, të cilët janë të angazhuar në çdo vit akademik dhe çdo semestër në programin e studimit Master Profesional “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes”.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, ka së paku gradën shkencore “Doktor” si dhe 8 prej tyre janë me tituj akademik “Profesor i Asociuar” apo “Profesor”. Formimi i tyre doktoral, por edhe fusha kërkimore, referuar CV-së, është në përputhje me angazhimin akademik dhe lëndët përkatëse ku ata janë të angazhuar.</p> <p>GVJ konstaton një tërësi dokumentesh që argumentojnë përmbushjen e kriterit, si lista e stafit akademik, CV e stafit akademik dhe ai ndihmës akademik, dosje personeli efektiv dhe me kontratë etj., të cilat disponohen nga departamenti përgjegjës, Departamenti i Matematikës dhe Informatikës si dhe zyra e burimeve njerëzore në institucion. GVJ evidenton se stafi akademik angazhuar në këtë program studimi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik.</p> <p>[Dok. 17. Pedagoget e Ftuar ne FEA për Vitin Akademik 2022-2023.], [Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB-tabela 1; 2; 6.1-6.3], [Dok. 16. CV e Stafit Akademik të Programit të Studimit MP_MIA.], [Dok. 18. CV e stafit ndihmës akademik]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik, në varësi të ngarkesës mësimore të stafit akademik ekzistues (në bazë të Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018), Departamenti parashtron nevojat për staf akademik efektiv dhe të ftuar si edhe orët mësimore përkatëse.</p> <p>[Dok. 63. Udhëzimi Nr. 29, date10.9.2018.], [Dok. 2. Statuti i UBT.], [Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB – tabela 12]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit, dëshmon për qëndrueshmëri dhe kjo bazuar në vitet e gjata apo të konsiderueshme që stafi akademik është pjesë e UBT, por edhe në mësimdhënie në këtë program studimi.</p>

<p>e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacion por edhe gjatë vizitës në institucion në Zyrën e Burimeve Njerëzore, evidentoi edhe në dosjet e stafit akademik të ftuar si edhe atë me kohë të pjesshme, ndër dokumentet e tjera janë edhe kontratat përkatëse të tyre.</p> <p>[Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB -tabela 6.], [Dok. 16. CV e Stafit Akademik të Programit të Studimit MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik me kohë të plotë, me kontratë të përkohshme dhe të ftuar në Departamentin e Matematikës dhe Informatikës bëhet në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet e tjera ligjore dhe në nën ligjore, të shprehur në Statutin e UBT, nenet 47 dhe 48 dhe në Rregulloren për Rekrutimin e Stafit Akademik, Ndhimës dhe Administrativ UBT, neni 3.</p> <p>Referuar procedurës së konsultuar të rekrutimit, GVJ konstaton se UBT, harton dhe zbaton procedura rekrutimi, të mbështetura në vlerësimin e aplikantëve në dy faza, atë të vlerësim dosjes dhe atë të intervistës. Vlerësimi i dosjes rezulton se bëhet nëpërmjet vlerësimit të kriterëve të përgjithshme dhe specifike, nga komisioni ad-hoc i përbërë nga 5 anëtarë, në përputhje me Rregulloren për Rekrutimin e Stafit Akademik, Ndhimës dhe Administrativ UBT, neni 3.</p> <p>[Dok. 2. Statuti i UBT.], [Dok. 60. Ligji i Arsimit të Lartë, Nr. 802015.], [Dok. 56. Rregullore për Rekrutimin e Stafit Akademik, Ndhimës dhe Administrativ UBT.], [Dok. 57. Procedurat e Rekrutimit.], [vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni, Departamenti i Matematikës dhe Informatikës, ka në përbërje të tij edhe 2 (dy) staf ndihmës akademik, të cilët janë përgjegjës për mirëmbajtjen e laboratorëve. Gjatë orëve të laboratorit, stafi akademik përgjegjës për lëndës në të cilat do të zhvillohen laboratorët, do të kryejnë laboratorët në prezencë të stafit ndihmës akademik, i cili asiston në mbarëvajtjen e këtij procesi. Pavarësisht së për këtë program studimi, nuk ka të specifikuar qartazi aktivitetet laboratorike në syllabuse dhe në planin mësimor, ato zhvillohen në kategorinë e seminareve/ushtrimeve.</p> <p>[Dok. 18. CV e stafit ndihmës akademik], [0.2 RVB_MP_MIA 13.02.2023]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna</p>	<p>UBT ka në strukturën e tij edhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike. Kjo drejtori ndër të tjera, është përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të</p>

<p>përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>pjesëshme) dhe administrativ të punësuar në FEA si edhe në të gjithë UBT.</p> <p>Nga takimi në zyrën e Burimeve Njerëzore GVJ konstatohet se për stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi disponohet dokumentacioni i nevojshëm dhe i gjithë dokumentacioni është i përfshirë në një dosje të vetme.</p> <p>GVJ u informua se të dhënat përditësohen periodikisht në fillim të vitit akademik ose atëherë kur kjo është e nevojshme si p.sh. shtimi i ndonjë gradë shkencore ose titulli akademik, etj. Për sa i përket angazhimit të personelit në çdo semestër dhe vit akademik, ky informacion mbahet nga Departamenti i Matematikës dhe Informatikës.</p> <p>[Dok. 8. Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave.], [Dok. 5. Rregullore e njësisë kryesore FEA.], [Dok. 16. CV e Stafit Akademik të Programit të Studimit MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me grupe interesi dhe partnerë si në fushën e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit ashtu edhe me subjekte private dhe shtetërore. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me 62 kompani dhe subjekte edhe për kryerjen e praktikës profesionale. Institucioni si edhe subjekti pritës për praktikën firmos kontratën e praktikës në të cilën përcaktohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet mes palëve.</p> <p>Subjekti pritës e udhëzon dhe e angazhon studentin gjatë periudhës së praktikës në detyra të ndryshme që lidhen me objektivat e formimit të programit të studimit, duke patur gjithmonë një person (punonjës të kompanisë) i cili mbikëqyr dhe udhëzon studentin.</p> <p>Punimi i diplomës kryhet nga studenti duke patur udhëheqës staf akademik të UBT me grada dhe tituj duke respektuar ligjet në fuqi sikurse edhe rregulloret përkatëse të Institucionit dhe të programit të studimit.</p> <p>[Dok. 28. Marrëveshje Bashkëpunimi me Institucionet Homologe dhe Aktorë Biznesi.], [Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB – tabela 5.1; 5.2], [Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA-neni 13; 14.], [Dok. 45. Kërkesa dhe Kontrata për Praktike Profesionale në MP_MIA]</p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në</p>	<p>Subjekti pritës, për praktikën profesionale të studentit, përcakton një person përgjegjës i cili duhet të udhëzojë studentin në të gjitha detyrat që ai duhet të kryejë.</p> <p>Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit relacionin e praktikës, të cilën më pas e prezanton para komisionit të ngritur në nivel departamenti. Pas përfundimit të praktikës, studenti dorëzon relacionin</p>

procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	e praktikës shoqëruar me një formular vlerësimi për të të bërë nga subjekti në të cilën është kryer praktika profesionale. [Dok. 45. Kërkesa dhe Kontrata për Praktike Profesionale ne MP_MIA], [Vizita në institucion- takimi me stafin akademik dhe Drejtuesin e Departamentit të Matematikës dhe Informatikë]		
Konkluzione	<i>Institucioni ka të angazhuar në këtë program studimi, staf akademik në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës. Stafit është i kualifikuar dhe i gjithi ka së paku gradën shkencore “Doktor”. Njësia bazë dhe ajo kryesore, përgjegjëse për këtë program studimi, plotëson kriteret ligjore si për numër stafi, ashtu edhe për kualifikimet e tyre.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe vizitat në institucion, GVJ konfirmon se FEA disponon mjediset të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse në auditor. Referuar të dhënave për infrastrukturën në funksion FEA rezulton se mjediset në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme duke qenë se në mundësohet rreth 3.52 m²/student (duke qenë afër normativës së sipërfaqes së shfrytëzueshme prej 3.8–4.0 m²/student). Në total për FEA sallat e leksionesh janë 14, me një sipërfaqe totale të tyre 2334.2 m² ndërsa salla seminaresh janë gjithsej 26 me sipërfaqe totale 1418.5 m². Në ambient disponohet një sallë për aktivitete promovuese dhe gjuhët e huaja me sipërfaqe 38 m², salla për praktika lëndore, konferenca et prej 87 m² etj..</p> <p>Nga ana tjetër, baza laboratorike garanton një zhvillim cilësor të procesit mësimor në përputhje me natyrën specifike të moduleve që ndërtojnë këtë program studimi.</p> <p>Fakulteti zotëron 3 laboratorë për lëndët dhe 4 laboratorë informatike, në total 312.08 m². Çdo salle informatike (laboratorë për informatikën) është e pajisur me hapësirën e nevojshme për zhvillimin normal të leksioneve/seminareve dhe kompjuterët janë të pajisur me programe profesionale. Fakulteti gjithashtu disponon edhe bibliotekën e cila ka një sërë botimesh në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Biblioteka është e</p>

	<p>pajisur edhe me kompjutera, në të cilat studentët mund të aksesojnë librarinë online TEEAL. Gjithashtu, studentët mund të përdorin kompjuterat në ambientin e bibliotekës edhe për punimet e tyre të diplomës, detyrave të kursit apo detyrave individuale në lëndë të ndryshme.</p> <p>[Dok. 27. Kapacitete dhe të dhëna për infrastrukturën FEA], [Vizitë e ambienteve]</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>FEA ka vënë në dispozicion të realizimit të këtij programi studimi mjedise, me kushte të përshtatshme dhe të pajisura me infrastrukturën e duhur për zhvillimin normal të procesit mësimor. Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të njihet me infrastrukturën mësimore në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Gjithashtu, mjediset e zhvillimit të procesit mësimor janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, video projektor, si mundësi aksesimi të internetit (lidhje wireless), etj.</p> <p>[Dok. 27. Kapacitete dhe të dhëna për infrastrukturën FEA], [Vizitë e ambienteve]</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për programin e studimit Master Profesional “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” realizimi i seancave të ushtrimeve, seminareve, detyrave të kursit dhe projekteve kërkon mbështetjen e një baze të fuqishme informatike. GVJ konstatoi se nga ana e institucionit në përgjithësi dhe FEA në veçanti i është kushtuar një vëmendje e veçantë pajisjes me infrastrukturën e duhur informatike në mbështetje të programit. Kjo infrastrukturë informatike është e mbështetur dhe nga sisteme shfrytëzimi dhe programe kompjuterike që i korrespondojnë nivelit të kërkuar të formimit Master Profesional.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës së ambienteve, pati rastin të njihet me karakteristikat e harduerit si dhe të programeve të karakterit të përgjithshëm dhe profesional të pranishëm në laboratorët përkatës.</p> <p>GVJ është i mendimit se kjo infrastrukturë informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivat formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p>[Dok. 27. Kapacitete dhe të dhëna për infrastrukturën FEA.], [Vizitë e ambienteve], [RVB]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Për vetë natyrën e programit të studimit, mbështetja për realizimin e tij janë laboratorët e informatikës, të cilët janë të pajisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementë e tij përbërës.</p> <p>[Evidenca: Vizita e ambienteve]</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>GVJ u informua se praktikat profesionale me studentët e programit të studimit Master Profesional “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” kryhen pranë subjekteve private e shtetërore sipas fushës së studimeve të studentit. Kjo mundësohet nga marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit me organizata dhe kompani të ndryshme që operojnë në vend (62 marrëveshje bashkëpunimi), duke krijuar mundësi të mira për të kryer praktikën profesionale (e cila është parashikuar me një vëllim prej 12 kreditesh ECTS) në shërbim të përfuturit të eksperiencave praktike nga ana e studentëve. Gjithashtu, GVJ u informua se, praktikat profesionale kanë shërbyer për studentët edhe si mbështetje për realizimin e temave të diplomave si dhe një mundësi për punësim në këto kompani.</p> <p>[Dok. 28. Marrëveshje Bashkëpunimi me Institucionet Homologe dhe Aktorë Biznesi]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka vënë në dispozicion të realizimit të këtij programi studimi mjedisë, me kushte të përshtatshme dhe të pajisura me infrastrukturën e duhur për zhvillimin normal të procesit mësimor.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedisë të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni sikurse edhe nga vizita në Institucion, nga takimet me stafin akademik si edhe vizita në ambientet e Bibliotekës Shkencore të UBT, si edhe Bibliotekës së FEA, evidenton se literatura bazë dhe ajo ndihmëse e përdorur është literaturë e viteve të fundit dhe që garanton përcjelljen në mënyrë efektive të dijeve dhe njohurive tek studentët e këtij programi studimi.</p> <p>[Dok. 15. Syllabusët e Moduleve MP_MIA], [Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, në fillim të çdo viti akademik, depoziton në Librarianë e UBT, të gjitha materialet e lëndës të tilla si: libra, monografi, leksione të shkruara etj. Gjithashtu në përfundim të çdo viti akademik, në nivel departamenti bëhet analiza mësimore dhe kërkimore shkencore ku evidenton arritjet por edhe problematikat. Ndër to në formë tabelare specifikohen të dhënat për literaturën për secilin modul dhe pedagog.</p>

	[Dok. 19. Analiza Mësimore dhe Kërkimore Shkencore DMI- pika 2.6], [0.2 RVB_MP_MIA 13.02.2023]
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se UBT zotëron një bibliotekë të pasur me botime të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij Institucioni. Por gjithashtu edhe FEA ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë të pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online. Biblioteka e FEA ka një kapacitet prej 100 vendesh dhe të pajisur edhe me kompjutera, 10 prej të cilëve janë të lidhur me bibliotekën online. Në ambientet e bibliotekës gjenden vende të cilat mund të përdoren nga studentët gjatë frekuentimit të bibliotekës në përputhje me orarin e funksionimit të saj. Gjatë vizitës në bibliotekën e UBT si edhe atë të FEA, GVJ u njoh me ambientet e bibliotekës dhe procedurat e përdorimit të saj nga ana e studentëve. Studentët kanë në dispozicion tekste mësimore në gjuhën shqipe të hartuar nga pedagogë të FEA si edhe nga pedagogë me emër të universiteteve të tjera në vend. FEA, ka siguruar një numër të konsiderueshëm tekstesh në mbështetje të programeve të studimit. Studentëve u mundësohet dhe akses në Bibliotekën Dixhitale JSTORE (tabela 17).</p> <p>[Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB -tabela 17.], [Dok. 36. Informacion nga Biblioteka Shkencore Mentor Përmeti.], [Dok. 27. Kapacitete dhe të dhëna për infrastrukturën FEA], [Evidenca: Vizita e ambienteve]</p>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<p>GVJ u informua se biblioteka e FEA ka rreth 500 tituj në gjuhën shqipe, 2200 tituj në gjuhë të huaj si edhe 1700 materiale periodikë. Ndërsa numri i titujve në Bibliotekën Shkencore të UBT është disa herë më shumë, me një larmi fushash dhe botimesh në shqip dhe në gjuhë të huaj.</p> <p>Të gjithë titujt e bibliotekës përditësohen rregullisht në databazën e Bibliotekës dhe çdokush, në çdo kohë mund të ketë akses tek titujt që janë gjendje (https://www.librariaubt.com/)</p> <p>Biblioteka e FEA ka një kapacitet prej 100 vendesh dhe të pajisur edhe me kompjutera, 10 prej të cilëve janë të lidhur me bibliotekën online.</p> <p>[Dok. 36. Informacion nga Biblioteka Shkencore Mentor Përmetin], [Vizita e ambienteve]</p>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	<p>UBT ka akses në bibliotekën digjitale e mundësuar përmes pjesëmarrjes në projekte të ndryshme si p.sh. Erasmus+ LNSS apo Research4life. Biblioteka dixhitale ofron një mori artikuj të revistave akademike, libra si edhe dokumente në një sërë disiplinash. Biblioteka online është e aksesueshme falas nga studentët dhe stafi akademik.</p>

	<p>Studentëve u mundësohet dhe aksesimi në Bibliotekën Dixhitale JSTORE, duke mundësuar në këtë mënyrë qasje online në një numër të madh bazash të dhënash të bibliotekave të ndryshme.</p> <p>[Dok. 36. Informacion nga Biblioteka Shkencore Mentor Përmeti], [Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB -tabela 17], [0.2 RVB_MP_MIA 13.02.2023], [Vizita në bibliotekë]</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e UBT si edhe Biblioteka e FEA ndër të tjera, janë të pajisura secila me 10 kompjutera të cilët kanë akses dhe në internet duke mundësuar në këtë mënyrë dhe aksesimin në bibliotekat online të cilat institucioni ka abonime.</p> <p>[Dok. 36. Informacion nga Biblioteka Shkencore Mentor Përmeti], [Vizita në bibliotekë]</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e FEA sikurse edhe Biblioteka e UBT funksionon nga e hëna në të premte gjatë gjithë vitit akademi si edhe gjatë sezonit të provimeve duke ofruar shërbimet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Huazim i librave/teksteve. Studentët mund të regjistrohen duke paraqitur një vërtetim studentit, fotokopje të kartës së identitetit dhe një foto; - Sallë studimi; - Hapësirë për kryerjen e detyrave apo projekteve në grup. <p>GVJ, gjatë takimit që pati me studentët dhe stafin akademik të këtij program studimi, ju komunikua prej tyre fakti që për shkak të punësimit të studentëve të këtij program studimi, mësimi është organizuar të jetë kryesisht në fundjavë dhe mbas dite. Ky orar, nuk u krijon mundësi studentëve të këtij program studimi për përdorimin e ambienteve të Bibliotekës, por këta student mund të përdorin bibliotekën online.</p> <p>Studentët mund të gjejnë çdo informacion në lidhje me bibliotekën edhe në faqen zyrtare të bibliotekës:</p> <p>[https://www.ubt.edu.al/biblioteka-e-universitetit], [Vizita në bibliotekë]</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ u informua se shtimi i zërave të bibliotekës bëhet mbi bazën e kërkesave të bëra nga Departamentet duke u bazuar në buxhetin e institucionit. Gjithashtu, Institucioni, në kuadër edhe të projekteve në të cilat ka marrë pjesë, ka pasuruar edhe bibliotekën online duke qenë pjesë e një sërë platformave online.</p> <p>[Dok. 36. Informacion nga Biblioteka Shkencore Mentor Përmeti], [Vizita në bibliotekë]</p>

fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<i>UBT zotëron një bibliotekë të pasur me botime të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij Institucioni. Por gjithashtu edhe FEA ka vënë në dispozicion të studentëve një bibliotekë të pasur e cila përbëhet nga dy pjesë integrale: biblioteka me libra të printuar dhe biblioteka online.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Menaxhimi i informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit në FEA garantohet nga Rregulloret përkatëse. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që mbahet nga kjo Sekretari dhe që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër Regjistrin të arritjeve akademike dhe Regjistrin të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Regjistri themeltar gjithashtu mbahej në format elektronik ashtu edhe në formë fizike në regjistrin e miratuar nga QSHA.</p> <p>Gjithashtu, sekretaria mësimore nëpërmjet platformës Pitagora aktualisht dhe ESSE3 në vitet paraardhëse, administrojnë të gjithë informacionin e studentit nga regjistrimi i tij e deri në përfundim të studimeve, për detyrimet e lëndëve, vlerësimin etj.</p> <p>[Dok. 7. Rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ.], [Dok. 4. Rregullore për Studimet Universitare UBT.], [Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA.], [Dok. 5. Rregullore e njësisë kryesore FEA.], [Dok. 35. Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora], [Vizitë në sekretarinë mësimore]</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës	GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion sikurse edhe nga takimi që pati në institucion, evidentoi se Institucioni mban të dhënë të cilat rinovohen çdo vit në lidhje me stafin akademik, ndihmës akademik sikurse edhe atë administrativ apo edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që

<p>akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Institucioni ka me partner të ndryshëm për mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu në faqen zyrtare ueb të Institucionit prezantohet i gjithë aktiviteti i kryer prej stafit akademik, ndihmës akademik, studentët sikurse edhe bashkëpunimet që institucioni ka me partner të ndryshëm.</p> <p>[Vizita në institucion], [https://www.ubt.edu.al/]</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët që në momentin e regjistrimit në një program studimi, pajiset me adresë email-i personale me anë të të cilës komunikojnë në vazhdimësi për çdo gjë me stafin akademik të programit, stafin administrative etj. Gjithashtu stafi akademik i programit të studimit, komunikon me studentët nëpërmjet adresave të emailit të tyre por gjithashtu edhe nëpërmjet platformave të ndryshme si p.sh.. Teams, për hedhjen e materiale apo leksioneve të ndryshme.</p> <p>[Dok. 33. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative “GOOGLE APPS”.], [Dok. 34. Manual Klase Virtuale ZOOM.], [Dok. 35. Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora], [Vizita në sekretarinë mësimore]</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Për të mundësuar komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, FEA gjithashtu ka përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike. Nëpërmjet Microsoft Teams si dhe ZOOM janë zhvilluar seanca mësimore gjatë pandemisë (mësim online), ndërsa me rikthimin në auditor, platforma është përdorur për komunikime mes palëve, ngarkim detyrash/projektsh, njoftime, informacione etj. Gjithashtu gjithë stafi dhe studentët e FEA janë të pajisur me adresa email-i zyrtare të formatit emer.mbiemer@ubt.edu.al duke u përdorur edhe kjo formë komunikimi nga pedagogët dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>[Evidenca: Takime në institucion], [Dok. 33. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative “GOOGLE APPS”.], [Dok. 34. Manual Klase Virtuale ZOOM]</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Gjithashtu, në dispozicion është platforma ZOOM faqet zyrtare të UBT dhe FEA ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë.</p> <p>[Dok. 34. Manual Klase Virtuale ZOOM], [Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin</p>	<p>Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet</p>

<p>akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>faqes elektronike të UBT si dhe faqes elektronike të FEA, të cilat rezultojnë të përditësuara. Gjenden informacione të detajuara lidhur me planin mësimor të programit të studimit. Në faqen e FEA jepet informacion dhe për kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional, etj.</p> <p>GVJ eksplori mundësitë e ofruara për përfitim të informacionit dhe është i mendimit se informacioni i paraqitur është me interes si për studentët ashtu dhe për kandidatët për studentë.</p> <p>[https://www.ubt.edu.al/master], [https://www.ubt.edu.al/pranime-regjistrime], [https://www.ubt.edu.al/fea], [https://www.ubt.edu.al/blog]</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore.</i> <i>Informacioni në lidhje me stafin akademik PAE, PAK dhe ndihmës akademik mbahet nga Zyra e burimeve njerëzore.</i> <i>Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitetet e ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UBT si dhe faqes elektronike të FEA, të cilat rezultojnë të përditësuara.</i> <i>Të dhënat për të gjithë studentët e UBT menaxhohen në sistemin online Pitagora</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="563 1115 751 1182">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="759 1115 986 1182">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="994 1115 1198 1182">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="563 1193 751 1238"></td> <td data-bbox="759 1193 986 1238"></td> <td data-bbox="994 1193 1198 1238" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në nivel institucioni, hartohen raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar si dhe raportohet për realizimin e objektivave të institucionit. Menaxhimi i aspekteve financiare në nivel njësie kryesore mbulohet nga Administratori i FEA, ndërsa në nivel institucioni nga Administratori i UBT dhe Bordi i Administrimit duke siguruar edhe komunikimin me Senatin akademik dhe Rektorin e UBT. Buxheti i UBT-së alokohet sipas njësisive kryesore, të cilat janë njëkohësisht dhe njësi shpenzuese. GVJ konstatoi se nuk ka një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të</p>

	<p>studimit. Megjithatë, duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme të UBT (me të ardhura të konsiderueshme nga tarifat e studentëve dhe një numër të madh të të studentëve të riregjistruar) GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për të më tepër se një cikël të plotë studimi.</p> <p>[Dok. 25. Relacion për realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimi 2022 FEA.], [Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB-tabela 17]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Në Statutin përcaktohet se veprimtaria e UBT financohet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> buxheti i shtetit; pagesat e studentëve për arsimim; të ardhurat për shërbimet e kryera; të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta; donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi; veprimtari kërkimore-shkencore; projekte lokale, kombëtare e ndërkombëtare. <p>Bordi i Administrimit është organi më i lartë Kolegjial administrativ i UBT-së i cili garanton mbarëvajtje financiare dhe administrative të tij. Detyrat e tij janë të përcaktuara në Statut dhe në Rregullore të UBT-së. Me propozim të Senatit Akademik ai miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm si edhe garanton zbatimin e tij. Ai përcakton edhe rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që sigurohen nga ushtrimi i veprimtarisë si edhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit. Në nivel institucioni autoriteti drejtues administrativ është Administratori i UBT, ndërsa në nivel njësie kryesore është Administratori i FEA. Akti më i rëndësishëm në lidhje me aspektet e menaxhimit të institucionit është miratimi i Buxhetit të institucionit.</p> <p>GVJ konstatoi se procesi i hartimit të projekt buxhetit është gjithëpërfshirës dhe miratohet me vendim të Bordit të Administrimit të UBT-së. Projekt buxheti parashikon në mënyrë të detajuar sipas njësisë kryesore gjithë elementët përbërës të tij dhe hartohet mbi bazën e propozimeve të cilat e kanë burimin në nevojat e identifikuar nga Departamentet të pasqyruara në raportet e analizës vjetore të organizuara për analizën e ecurisë së programeve mësimore që mbulohen prej tyre.</p> <p>[Dok. 2. Statuti i UBT.], [Dok. 5. Rregullore e njësisë kryesore FEA.], [Dok. 25. Relacion për realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimi 2022 FEA], [https://www.ubt.edu.al/organigram-a-ubt]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni i nënshtrohet në mënyrë periodike auditimit të brendshëm organizuar nga strukturat përkatëse në varësi të drejtpërdrejtë të Bordit të Administrimit të UBT-së dhe auditimit të jashtëm ushtruar nga strukturat shtetërore financiare dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Në strukturën administrative të UBT është dhe Sektori i Auditit të</p>

	<p>Brendshëm, e cila ndër të tjera auditon përputhshmërinë, performancën, kryen auditimin financiar të të gjitha njësive shpenzuese në UBT-së, si dhe auditim të kombinuar që synon përdorimin me efektivitet dhe eficientë të fondeve të UBT.</p> <p>[Dok. 25. Relacion për realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimi 2022 FEA], [https://www.ubt.edu.al/organigrama-ubt]</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>UBT paraqet në MAS në fund të çdo viti akademik raportet vjetore për veprimtarinë e kryer, gjendjen financiare të institucionit, parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifat e shkollimit për vitin në vijim. Raportet financiare ruhen të dokumentuar përmes zbatimit të procedurës së miratuar në lidhje me ruajtjen dhe arkivimin e tyre. Drejtoria Ekonomike dhe e Financës është përgjegjëse për raportimin e realizimit të zërave të parashikuar në buxhetin financiar. Planifikimet dhe ndërhyrjet parashikohen në buxhetet afatmesme dhe ato synojnë garantimin e mbarëvajtjes së të gjitha programeve të studimit.</p> <p>[Dok. 25. Relacion për realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimi 2022 FEA], [https://www.ubt.edu.al/organigrama-ubt]</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësive bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>UBT dhe vetë program i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit.</p> <p>[Dok. 25. Relacion për realizimin e buxhetit 2021 dhe planifikimi 2022 FEA], [https://www.ubt.edu.al/organigrama-ubt]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UBT dhe vetë program i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X



<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se për programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin e UBT, Rregulloren e FEA, Rregulloren për Studimet Universitare UBT, dhe Rregulloren e programit të studimit. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e FEA zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantoet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi.</p> <p>[Dok. 2. Statuti i UBT.], [Dok. 5. Rregullore e njësisë kryesore FEA.], [Dok. 4. Rregullore për Studimet Universitare UBT.], [Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Takime në institucion]</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se DMI ndjek politika dhe procedura të mirë përcaktuara që garantojnë barazinë tek studentët në këtë program studimi. Statuti dhe rregulloret institucionale garantojnë mundësi të barabarta për kushtet materiale dhe financim të mësimdhënies si edhe kërkimit shkencor. Procedurat e ndjekura janë në përputhje edhe me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore në fuqi të kërkuara edhe nga MAS. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga DMI dhe mbikëqyret dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese që veprojnë sipas hierarkisë, me kompetenca të përcaktuara në ligjin e Arsimit të Lartë, në rregullore dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe regjistrimit, format e mësimdhënies, kërkesat për pjesëmarrjen e studentëve në mësim, kontrollin e dijeve dhe sistemin e vlerësimit, organizimin e praktikave profesionale, mënyrën e diplomimit etj., i gjejmë të shprehura në Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>Diplomimi i studentëve realizohet në përputhje me Rregulloren për Studimet Universitare UBT dhe pajisja e studentit me diplomë sipas</p>

	<p>formatit të miratuar shoqërohet dhe me suplementin e diplomës. Të gjitha procedurat garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>[Dok. 2. Statuti i UBT.], [Dok. 5. Rregullore e njësisë kryesore FEA.], [Dok. 4. Rregullore për Studimet Universitare UBT.], [Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA]</p>												
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e pranimit dhe procedurën për t'u ndjekur, jepen në Rregulloren e Programit të Studimit dhe në Rregulloren për Studimet Universitare UBT. Njoftimet shoqëruar me kriteret e pranimit janë të aksesueshme nëpërmjet faqes së internetit të UBT/FEA.</p> <p>GVJ konstatoi se kriteri specifik që lidhet me notën mesatare të ciklit Bachelor për pranimin në këtë program studimi është nota mbi 6. Nota mesatare në hyrje e aplikantëve është 6.1 në vitin akademik 2020-2021, 6.61 në vitin akademik 2021-2022 dhe 6.37 në vitin akademik 2022-2023.</p> <p>[Dok. 4. Rregullore për Studimet Universitare UBT.], [Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA.], [Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB - tabela 21], [https://www.ubt.edu.al/pranime-regjistrime]</p>												
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatën Akademik.</p> <p>Kriteret e pranimit bëhen publike në faqen e internetit të FEA janë:</p> <p>Elementë më të detajuar lidhur me pranimin e studentëve jepen në Rregulloren e programit të studimit (Neni 9 – Pranimi i studentëve). Përzgjedhja e aplikantëve fitues kryhet nga një komision <i>ad-hoc</i> i ngritur nga Dekani i FEA me propozim të DMI. Përzgjedhja kryhet mbi bazën e mesatares së arritur në studimet e ciklit Bachelor x koeficient (për përputhmërinë e studimeve Bsc me ato të MP që po aplikon). Elementët e tjerë që lidhen me vlerësimin e dijeve (neni 29- 31) dhe diplomimin (neni 14; 16) gjenden në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Referuar tabelës së mëposhtme, në tre vitet e pasqyruar, në këtë program studimi nuk ka patur transferime dhe në total për këto vite, kanë qenë 32 student.</p> <table border="1" data-bbox="576 1644 1401 1863"> <thead> <tr> <th colspan="4">Master i Profesional në "Menaxhim Informacioni në Agrobiznes"</th> </tr> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë</th> <th>Studentë të transferuar sipas viteve</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>19</td> <td>-</td> <td>19</td> </tr> </tbody> </table>	Master i Profesional në "Menaxhim Informacioni në Agrobiznes"				Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali	2020-2021	19	-	19
Master i Profesional në "Menaxhim Informacioni në Agrobiznes"													
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali										
2020-2021	19	-	19										

	<table border="1"> <tr> <td>2021-2022</td> <td>7</td> <td>-</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>6</td> <td>-</td> <td>6</td> </tr> </table> <p>[Dok. 4. Rregullore për Studimet Universitare UBT.], [Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA.], [Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB - tabela 21], [https://www.ubt.edu.al/pranime-regjistrime]</p>	2021-2022	7	-	7	2022-2023	6	-	6
2021-2022	7	-	7						
2022-2023	6	-	6						
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kërkesat e kriteret për këtë program studimi publikohen në faqen ueb përpara fillimit të vitit akademik. Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimit Master Profesional në Menaxhim Informacioni në Agrobiznes.</p> <p>Gjithashtu, institucioni merr pjesë në mënyrë të përvisthme në Panairin “Work and Study” ku paraqitet e gjithë oferta didaktike, kriteret dhe mundësit e ofruara nga UBT.</p> <p>[0.2 RVB_MP_MIA 13.02.2023], [2.-FEA_Fletepalosje], [Takime në institucion]</p>								
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.</p>	<p>UBT ndjek politika të mbështetje së kategorive sociale të veçanta. Kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve nga këto kategori bëhen publike para fillimit të vitit akademik në faqen ueb të institucionit.</p> <p>Pranimi i studentëve bazohet në aktet e brendshme rregullatore, duke përcaktuar kriteret e veçanta për pranimin në vartësi të programit specifik të studimit. Megjithatë, referuar pranimit të studentët në këtë program studimi, vërehet se institucioni ka hartuar kriteret specifike të cilat nuk i përfshijnë apo motivojnë studentët që kanë mbaruar studimet bachelor jashtë fushë së studimit në ekonomi.</p> <p>Studentët që kanë mbaruar studimet bachelor në fushën e ekonomisë, nota e tyre e ponderuar e studimeve bachelor peshohet me një koeficient që varion nga 0.8 në 1 nëse kanë mbaruar në fushën e ekonomisë jashtë UBT apo në UBT.</p> <p>Për studentë të cilët kanë mbaruar studime në UBT, jashtë profilit ekonomik, nota e tyre e studimeve bachelor peshohet me koeficientin 0.75.</p> <p>Sipas këtij kriteri, studentët e drejtimeve bachelor në Informatikë Biznesi, po në UBT, vlerësohen me koeficientin 0.75 kundrejt kolegëve që kanë mbaruar në drejtimin ekonomik të cilët vlerësohen me koeficientin 1.</p>								



	<p><i>Duke qenë ky program studimi me karakter jo vetëm ekonomik, por edhe në teknologji informacioni, gjykojmë se kriteret specifike të pranimit të studentëve në këtë program studimi, duhet të rishikohet më mirë nga institucioni për të qartësuar dhe vlerësuar më mirë studentët duke rritur cilësinë e studentëve që pranohen në këtë program</i></p> <p>[Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Dok.50. Propozimi i Kriereve 2023-2024], [https://ualbania.al/]</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, neni 19, pika c, thuhet se në këtë program studimi kanë të drejtë të transferojnë studimet shtetas shqiptar ose te huaj, por sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullores së studimeve në UPT. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ nuk evidentoi ndonjë regjistrim të shtetasve të huaj në këtë program studimi.</p> <p>[Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA]</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni, ofron bursë apo përjashtim nga tarifa për vitin akademik për studentët, bazuar në mesataren e notave të arritura ose për shtresa në nevojë. Kjo përzgjedhje e studentëve, behët bazuar brenda kuadrit ligjor në vend dhe bazuar në Rregulloren për studimet universitare në UBT.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidentoi se për këtë program studimi nuk kishte studentë që përfitonin bursë apo përjashtim nga pagesa e tarifës për vitin akademik.</p> <p>[Dok. 4. Rregullore për Studimet Universitare UBT.], [Dok. 73. Njoftim për Studentet për Përjashtimin nga Tarifa për Vitin Akademik 2022-2023.], [Dok. 74. Njoftim për Studentet për Përfitimin e Bursës për Vitin Akademik 2022-2023.]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se për programin e studimit Master Profesional në "Menaxhim Informacioni në Agrobiznes" pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin e UBT, Rregulloren e FEA, Rregulloren për Studimet Universitare UBT dhe Rregulloren e programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” realizohet me 120 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja akademike është 2 vjet. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite (60 vitin e parë dhe 60 vitin e dytë). Studimet e këtij programi përmbyllen me punim diplome. Studentët e programit të studimit njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet informacioneve në faqen së internetit të FEA. Elementë më të detajuar lidhur me planin mësimor, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin gjenden në rregulloret përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Rregullorja e programit të studimit Master Profesional në "Menaxhim Informacioni në Agrobiznes" – Rregullore për Studimet Universitare UBT; <p>[Dok. 4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [https://www.ubt.edu.al/pranime-regjistrime]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Neni 67 i Statutit të UBT jep elementët që lidhen me transferimet dhe kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Studentët apo kandidatët për studentë në këtë program studimi mund të njihen me këta elementë duke aksesuar rregulloren e studimeve në UBT nëpërmjet linkut:</p> <p>https://www.ubt.edu.al/rregullore-e-studimve</p> <p>Elementë shtesë jepen edhe në Rregulloren për Studimet Universitare UBT (Neni 68 dhe 80).</p> <p>[Dok. 2. Statuti i UBT.], [Dok. 4. Rregullore për Studimet Universitare UBT], [Vizita në Sekretarinë Mësimore]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informacioni në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit përftohet nëpërmjet Rregullores për Studimet Universitare UBT dhe rregullores së programit të studimit. GVJ u informua se elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.</p> <p>[Dok. 4. Rregullore për Studimet Universitare UBT.], [Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA.], [Dok. 15. Syllabuset e Moduleve MP_MIA], [Takime në institucion]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me</p>	<p>GVJ u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e diplomimit në programin e studimit</p>

<p>kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes”. Në planin mësimor realizimit të temës së diplomës i janë rezervuar 18 kredite ECTS. Për realizimin e temës së diplomës studentët bazohen në rregulloren e programit të studimit dhe formatin e mikrotezës së ciklit të dytë të studimeve e cila i vihet në dispozicion. Në këtë të fundit jepen elementë mbi mënyrën e shkrimit dhe paraqitjes së punimit të diplomës mbi bazën e një template.</p> <p>[Dok. 5. Rregullore e njësisë kryesore FEA-neni 25.], [Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB, Tabela 10], [Dok. 4. Rregullore për Studimet Universitare UBT.], [Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA.], [Dok. 42. Template për temën e diplomës.], [Dok. 43. 3 Format Kërkese për Temë Diplome.], [Dok. 43. 1. Fusha Kërkimi dhe Tema Master]</p>		
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ u informua se institucioni, në fillim të çdo viti akademik, periodikisht përpara se studentët të përzgjedhin programet e tyre të studimit organizon takime të hapura informimi me ta, nëpërmjet zyrës së shërbimit ndaj studentëve e cila bashkëpunon me njësisë bazë përgjegjëse për secilin nga programet e studimit. Gjithashtu faqja e internetit e UBT (https://ubt.edu.al) ofron një gamë të gjerë informacionesh në lidhje me kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional dhe planin mësimor të programit të studimit.</p> <p>[Takime në institucion], [0.2 RVB_MP_MIA 13.02.2023]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Studentët e programit të studimit njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet informacioneve në faqen së internetit të FEA. Elementë më të detajuar lidhur me planin mësimor, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin gjenden në rregulloret përkatëse.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për</p>	<p>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët</p>


<p>strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës laboratorike e kompjuterike në dispozicion të tyre. Një pjesë e informacionit, si orari mësimor, struktura mësimore, data provimesh, konsultime, mbrojtje diplomash dhe praktikash mësimore etj., është i aksesueshëm edhe nëpërmjet faqes së internetit të FEA. Sekretaria mësimore gjithashtu ofron informacion të përgjithshëm mbi programet e studimit/lëndët përkatëse:</p> <p>[https://www.ubt.edu.al/orari-mesimor], [https://www.ubt.edu.al/fea-datat-e-shlyerjes-se-detyrimeve], [https://www.ubt.edu.al/grafiku-i-provimeve], [https://www.ubt.edu.al/njofitime-per-studentet], [https://www.ubt.edu.al/programet-e-studimit], [Takim me studentët]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konsultimi i faqes së internetit, takimet në institucion, GVJ u informua se UBT shpërndan informacion nëpërmjet faqes së internetit ku pasqyrohen Rregulloret dhe Statuti i institucionit si dhe një numër elementësh të tjerë duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë. Në faqen e internetit gjendet i publikuar edhe orari i programit të studimit. Syllabuset që çdo pedagog prezanton në fillim të lëndës japin informacion të qartë për përmbajtjen dhe kërkesat që studenti duhet të plotësojë.</p> <p>[https://www.ubt.edu.al/dokumenta-ubt], [https://www.ubt.edu.al/rregullore-e-studimve], [https://www.ubt.edu.al/grafiku-i-provimeve], [Takim në institucion]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në organigramën e UBT, në varësi të Zv. Rektorit për mësimin, është dhe Drejtorja e shërbimeve mësimore dhe studentëve, pjesë e të cilës është edhe Sektori i Karrierës dhe Alumni. Ndër aktivitetet më të rëndësishme të Qendrës së Karrierës është dhe Panairi i Karrierës si një aktivitet i përvitshëm dhe që jep mundësinë e zhvillimit të formës më bashkëkohore të rekrutimit të studentëve. Ai shërben si një urë e drejtpërdrejte komunikimi mes tregut të punës dhe punëkërkuësve të ardhshëm (studentëve) nga çdo fushë studimi e UBT. Ky aktivitet është frytdhënës për të dy palët, pasi Universiteti promovon studentët e tij dhe subjektet pjesëmarrëse rritin cilësisht burimet e tyre njerëzore. Zhvilluar në ambientet e UBT, një numër i madh subjektësh vijnë me standat e tyre</p>

	<p>për të ofruar mundësi konkrete për studentët dhe alumnin e Universitetit (punësim, internship-e, trajnime, workshop-e, etj).</p> <p>Në faqen e internetit të UBT në mënyrë të vazhdueshme publikohen njoftime për mundësi internship-i apo punësimi për studentët. GVJ, nga takimi i zhvilluar me zyrën e karrierës së UBT si dhe nga shqyrtimi i informacionit të DVV dhe faqes së internetit, është i mendimit se lidhja me biznesin është në nivele shumë të kënaqshme dhe se mbështetet fuqimisht orientimi i studentëve drejt dhe në tregun e punës.</p> <p>[Dok. 37. Qendra e Karrierës dhe ALUMNI, UBT.], [Dok. 40. Ftese Panairi VII i Karrierës Qershor 2022, UBT.], [Dok. 41. Raport Panairi i Karrierës, 2022.], [Dok. 39. Raporti GRADUA - Vrojtimi i profilit të studenteve.], [Takim më Zyrën e Karrierës] [https://www.ubt.edu.al/njoftime-per-studentet], [https://www.ubt.edu.al/organigrama-ubt], [https://www.ubt.edu.al/panairi-i-karrieres], [https://www.ubt.edu.al/blog/aktivitete-studentore-10/mundesi-per-praktika-nderkombetare-edhe-certifikate-per-studentet-e-universitetit-bujqesor-37]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimëve, struktura e vitit akademik, datat e provimeve apo datat e shlyerjeve të detyrimeve, aksesohen gjithashtu edhe nëpërmjet faqes së internetit të UBT dhe FEA. Po ashtu, nëpërmjet faqes së internetit mund të përftohen edhe njoftime për tarifat e studimit etj.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Sekretaria Mësimore. GVJ e gjen një praktikë të tillë në përputhje me standardin.</p> <p>[https://www.ubt.edu.al/dokumenta-ubt], [https://www.ubt.edu.al/rregullore-e-studimve], [https://www.ubt.edu.al/grafiku-i-provimeve], [https://www.ubt.edu.al/blog/universiteti-13/njoftim-per-pagesen-e-tarifes-se-shkollimit-faturat-e-kestit-te-dyte-per-vitin-akademik-2021-2022-72], [https://www.ubt.edu.al/kampusi-i-ubt], [Takime në institucion]</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ u informua se sistemi Pitagora mundëson hyrje e dedikuar të studentëve dhe stafit nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar. Gjithashtu, në dispozicion janë dhe faqet zyrtare të UBT dhe FEA ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe</p>

	administrativ që do të informojë. Komunikimi midis stafit akademik dhe studentëve ndër të tjera mund të realizohet edhe nëpërmjet e-mailit. [Dok. 35. Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora], [Vizita në institucion]			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Në organigramën e UBT, nën varësinë e Zv. Rektorit për mësimin është edhe Drejtoria e shërbimeve mësimore dhe studentëve. Pjesë e kësaj Drejtorie janë 3 sektorë: Sektori i Sekretarisë mësimore dhe shërbimit për studentët; Sektori i Karrierës dhe Alumnit dhe Sektori i Statistikës. Sektori i Sekretarisë mësimore dhe shërbimit për studentët ka përgjegjësi për regjistrimin e studentëve, pajisjen e tyre me adresë emaili, si dhe regjistrimi i tyre në platformën Pitagora. Sektori i Statistikave është një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat mbahen në formë të shkruar dhe elektronike në regjistrin e lëshimit të diplomave. Në programin e studimit Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” në periudhën 2020-2021 janë diplomuar gjithsej 16 studentë. [Dok. 35. Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora.], [Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB – tabela 23], [https://www.ubt.edu.al/organigrama-ubt], [Vizitë në sekretarinë mësimore]
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të	Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore dhe shërbimit për studentët. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit. Regjistrimet, për tre vitet e fundit paraqiten si vijon:

vitet akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Master i Profesional në "Menaxhim Informacioni në Agrobiznes"			
	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali
	2020-2021	19	-	50
	2021-2022	7	-	52
	2022-2023	6	-	58
	<p>Në Sekretarinë mësimore GVJ konstatoi se Regjistri themeltar në momentin e vizitës, ishte i disponueshëm në formë fizike në regjistrin e miratuar nga QSHA.</p> <p>[Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB – tabela 21], Vizitë në sekretarinë mësimore]</p>			
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit nëpërmjet platformës Pitagora. Për të garantuar sigurinë e informacionit, hyrja realizohet nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar.</p> <p>[Dok. 35. Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora], [Vizitë në sekretarinë mësimore]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësisve përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Institucioni mban të dhënat në mënyrë manuale në regjistra specifike, gjithashtu edhe në mënyrë elektronike. Këto të dhëna kontrollohen nga personat e autorizuar dhe ruhen sipas rregulloreve përkatëse në UBT.</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti, Sekretaria Mësimore dhe Sektori i statistikës disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Qendra e Karrierës dhe Alumni analizojnë gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave (përgjithësisht vjetore) si në nivel Departamenti, Fakulteti apo Universiteti. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel institucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik.</p> <p>Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon:</p>			




	Master i Profesional në "Menaxhim Informacioni në Agrobiznes"			
	Viti akademik	2020-2021	2021-2022	2022-2023
	Nota mesatare në hyrje	6.1	6.61	6.37
	Të dhënat në lidhje me punësimin e tyre për periudhën 2020-2022 janë:			
	Numri total i të diplomuarve	Të punësuarit në përputhje me diplomën	Të punësuarit jo në përputhje me diplomën	Të papërcaktuar
	16	3	5	8
	[Dok. 19. Analiza Mësimore dhe Kërkimore Shkencore DMI.], [Dok. 20. 1. Analiza Mësimore Kërkimore FEA 2021-2022.], [Dok. 24. Plan veprimi FEA 2022-2023], [Takime në institucion], [Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB – tabela 21; 23]			
Konkluzione	<i>Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore dhe shërbimit për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Statuti i UBT (neni 54, 14 dhe 65), përcakton se studentët, në përputhje me aktet ligjore dhe ato rregullatore të UBT, janë të përfaqësuar në Senatin akademik, kanë përfaqësuesin e tyre në zyrën e NJBSC, marrin pjesë në Këshillin e Etikës, Komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës në UBT. Gjithashtu studentët mund të marrin pjesë edhe në Forumin Ekonomik Studentor. [Dok. 2. Statuti i UBT.], [Dok. 54. Forumi Ekonomik Studentor], [https://www.ubt.edu.al/klubet-studentore], [https://www.ubt.edu.al/aktivitete-studentore]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo	UBT garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, NJSBC,

<p>vlërësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Këshillin e Etikës dhe në të gjitha komisionet e organizuara në UBT si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm dhe përgatitjen e RVB.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me kontributin e studentit pjesë e GVB në përgatitjen e RVB, duke mbajtur kontaktet me studentët dhe sugjerimet që studentët mund të kishin në raport me kurrikulën. Përveç sa më sipër, studentët marrin pjesë dhe në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të lëndës nga studenti, i cili plotësohet në fund të çdo semestri si dhe në vlerësimin e praktikës mësimore nëpërmjet formularit përkatës.</p> <p>GVJ u informua mbi përpunimin e rezultateve të pyetësorëve dhe vënien në dispozicion si në Departament ashtu edhe drejtuesve njësisë kryesore dhe Institucionit. Rezultatet reflektohen edhe në raportet vjetore që hartohen në nivel departamenti dhe njësie kryesore.</p> <p>[Dok. 2. Statuti i UBT.], [Dok. 32. 2. Format Pyetësori i studenteve FEA.], [Dok. 19. Analiza Mësimore dhe Kërkimore Shkencore DMI.], [Dok. 20. 1. Analiza Mësimore Kërkimore FEA 2021-2022], [Takim me GVB]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të institucionit (Senat, NJSBC, Këshillin e Etikës, GVB etj.). Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të studentëve tërhiqet, ndërmyjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetësorit të vlerësimit të lëndës nga studenti, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme.</p> <p>[Dok. 2. Statuti i UBT.], [Dok. 32. 2. Format Pyetësori i studenteve FEA.], [Dok. 19. Analiza Mësimore dhe Kërkimore Shkencore DMI.], [Dok. 20. 1. Analiza Mësimore Kërkimore FEA 2021-2022]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Për sa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, zbatohen procedurat e përcaktuara në rregulloret përkatëse. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. GVJ, bazuar në takimet me studentët dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konkludon se studentët kanë të drejtën e rivlerësimit të kontrollit të dijeve të bëra nga stafi akademik dhe të drejtën e ankimimit. GVJ konstatoi në takimin me studentët se ata ishin të mirinformuar në këtë drejtim dhe se kishin patur raste të ballafaqimit me pedagogët për sa i përket vlerësimit, por që nuk kishin arritur deri në fazën e paraqitjes së ankimimit me shkrim. Nga takimi i GVJ me studentët, rezultoi që procedura realizohet në përputhje me rregulloren.</p>

	[Dok. 5. Rregullore e njësisë kryesore FEA.], [Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA], [Evidenca: Takim me studentët]		
Konkluzione	<i>UBT garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, NJSBC, Këshillin e Etikës dhe në të gjitha komisionet e organizuara në UBT si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm dhe përgatitjen e RVB.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>GVJ konstatoi në UBT dhe FEA ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UBT. Në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Karrierës dhe studentëve; - Zyra e studimeve dhe studentëve; <p>Sekretaria mësimore dhe sekretaria e departamentit.</p> <p>[Dok. 51. Lista e Shërbimeve në ZSS.], [Dok. 7. Rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ.], [https://www.ubt.edu.al/zyra-e-studimeve-dhe-studenteve], [https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni]</p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>GVJ konstatoi se një mjet i fuqishëm për informimin e studentëve është dhe faqja e internetit e UBT e cila përditësohet rregullisht dhe që nga studentët informohen për një seri elementësh si njoftime për mobilitete, aplikime për bursa, trajnime, internship-e, webinarë, trajnime, leksione të hapur etj. Gjithashtu në faqen e internetit, gjendet informacion edhe për orarin mësimor si edhe për datat e provimeve.</p> <p>[Dok. 2. Statuti i UBT], [https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni], [https://www.ubt.edu.al/blog/aktivitete-studentore-10],</p>

	<p>[https://www.ubt.edu.al/orari-mesimor], [https://www.ubt.edu.al/grafiku-i-provimeve], [https://www.ubt.edu.al/njoftime-per-studentet]</p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ u informua për funksionimin në UBT të Qendrës së Karrierës. Ndër aktivitetet të cilat mbulohen nga kjo qendër mund të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i leksioneve të hapura, - Organizimi i trajnimeve, workshop-eve, - Organizimi i Panairit të Karrierës (i fundit i organizuar në Qershor 2022, ku morën pjesë mbi 60 kompani dhe përfaqësues të institucioneve); - Informacion në lidhje me mobilitetet dhe bursat e studimeve jashtë vendit, si edhe ndihmë përgjatë gjithë procesit të aplikimit, si edhe informacion mbi mbrojtjen e testeve të gjuhës angleze TOEFL dhe TOEIC; - Mundësimi i internship-eve, duke bashkëpunuar ngushtësisht me partnerët; - Mundësi Punësimi, duke shërbyer si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës. <p>[https://www.ubt.edu.al/qendra-e-karrieres-dhe-alumni], [https://www.ubt.edu.al/njoftime-per-studentet], [Dok. 37. Qendra e Karrierës dhe ALUMNI, UBT.], [Dok. 41. Raport Panairi i Karrierës, 2022], Takim më Zyrën e Karrierës]</p>		
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Qendra e Karrierës, duke shërbyer si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, synon edhe grumbullimin e informacionit që lidhet me të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe anketimi për gjurmimin e studenteve i organizuar së fundmi për punësimin e studentëve të diplomuar. Nga ky anketim për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022, janë diplomuar 16 studentë, nga të cilët kanë plotësuar pyetësorin 8 studentë. Ka rezultuar se 3 studentë të diplomuar janë punësuar në përputhje me diplomën dhe 5 studentë janë punësuar jo në përputhje me diplomën. GVJ u informua se nga ana e departamentit ka përpjekje për grumbullimin e këtij informacioni dhe koordinimi me zyrën e karrierës ka funksionuar plotësisht.</p> <p>[Dok. 38. Raport Gjurmimi i Studenteve ne UBT.], [Dok. 75. Tabelat përmbledhëse ANEKS_RVB , tabela 23], Takim më Zyrën e Karrierës]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi në UBT dhe FEA ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UBT..</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Bazuar edhe në Plan veprimin për vitin akademik 2022-2023, ndër të tjera janë hartuar edhe plan veprimet për përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p>UBT, përdor sistemin e-learning sikurse edhe sistemin MOODLE. Stafi akademik ka website të tyre personale.</p> <p>Gjithashtu, aktive në UBT ndër të tjera është edhe përdorimi i bibliotekës online TEEAL.</p> <p>[Dok. 24. Plan veprimi FEA 2022-2023.], [Dok. 33. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative “GOOGLE APPS”], [Dok. 34. Manual Klase Virtuale ZOOM]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Pedagogët e rinj të rekrutuar pranë UBT, ndjekin dhe marrin pjesë në orët e leksioneve të dhëna nga staf akademik PAE me eksperiencë dhe përvojë pranë UBT.</p> <p>Gjithashtu zhvillimi i vazhdueshëm i leksioneve të hapura pranë UBT, i vjen në ndihmë stafit të ri akademik për marrjen e eksperiencës dhe përvojës. Gjithashtu stafi akademik asistent lektor, vlerësohet çdo vit nëpërmjet një formulari të hartuar dhe miratuar në Dekanat në lidhje me disa elementë të tilla si: komunikimi, aftësia për të punuar në grup, cilësia e mësimdhënies, risitë dhe inovacioni në mësimdhënie, kërkimi shkencor etj.</p> <p>[Dok. 31. Trajnimet e Stafit të FEA.], [Dok. 59. Format Vlerësim Performance]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë</p>	<p>UBT, organizon në përfundim të çdo semestri anketimin e studentëve, të cilët shprehin lirshëm mendimin dhe opinionin e tyre në lidhje me pedagogët e lëndëve që ata kanë zhvilluar në semestrin përkatës. Të dhënat e mbledhura, përpunohen në nivel departamenti të cilët së bashku</p>

mundësinë e trajtimit të ankimeve.	<p>më përgjegjësit e grupeve mësimore diskutojnë në lidhje me problematikat e evidentuara duke ndërmarrë gjithashtu edhe masa për përmirësim dhe zgjidhje të problemeve në rast evidentimi të tyre.</p> <p>Sikurse theksohen në Rregulloren e FAE si edhe në rregulloren e programit të studimit, studenti ka të drejtën e ankimit të vlerësimit të bërë nga pedagogu i lëndës.</p> <p>[Dok. 32. 1. Pyetësi i studentëve online UBT.], [Dok. 32. 2. Format Pyetësi i studenteve FEA.], [Dok. 5. Rregullore e njësisë kryesore FEA.], [Dok. 6. Rregullore e programit të studimit MP_MIA]</p>		
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Sikurse edhe në kriterin më sipër, rezultatet e anketimit të studentëve bëhen publike fillimisht në departament. Pasi diskutohen në nivel departamenti, hartohet edhe raporti që pasi miratohet në njësinë bazë, përcillet në njësinë kryesore. Gjithashtu vlerësimi i stafit akademik bëhet edhe nga njësia bazë nëpërmjet formularit për vlerësimin e performancës. Raporti gjithashtu shqyrton edhe analizën mësimore kërkimore në nivel departamenti sikurse edhe në nivel fakulteti.</p> <p>[Dok. 7. Rregullore e DZHKKVI dhe DITNJ.], [Dok. 19. Analiza Mësimore dhe Kërkimore Shkencore DMI.], [Dok. 20. 1. Analiza Mësimore Kërkimore FEA 2021-2022]</p>		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Pjesë e Planit Strategjik të UBT, ndër të tjera është zhvillimi, trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i stafit, si në aspektin e mësimdhënies ashtu edhe në aspektin e kërkimit shkencor.</p> <p>UBT ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe në kuadër të projekteve Erasmus, organizon mobilitete të stafit akademik për mësimdhënie ashtu sikurse edhe për trajnime.</p> <p>[Dok. 3. Plani Strategjik UBT_2016-2025.], [Dok. 31. Trajnimet e Stafit të FEA.], [Dok. 29. Raport i Bashkëpunimit Institucional brenda dhe jashtë vendit, UBT.], [Dok. 30. Pjesëmarrja e Stafit në Projekte]</p>		
Konkluzione	<p><i>UBT, organizon në përfundim të çdo semestri anketimin e studentëve, të cilët shprehin lirshëm mendimin dhe opinionin e tyre në lidhje me pedagogët e lëndëve që ata kanë zhvilluar në semestrin përkatës. Të dhënat e mbledhura, përpunohen në nivel departamenti të cilët së bashku më përgjegjësit e grupeve mësimore diskutojnë në lidhje me problematikat e evidentuara duke ndërmarrë gjithashtu edhe masa për përmirësim dhe zgjidhje të problemeve në rast evidentimi të tyre.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Referuar Statutit, në UBT është ngritur Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë, e cila bashkëpunon dhe bashkërendon punën me njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. NJSBC e FEA është një strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e FEA. Kjo njësi është në varësi të drejtuesit të FEA - Dekanit të fakultetit dhe funksionon në bazë të rregullores përkatëse.</p> <p>[Dok. 2. Statuti i UBT, neni 85.], [Dok. 64. Manuali i Cilësisë UBT]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka ngritur një sërë mekanizmesh në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme të tilla si: rishikimi i kurrikulave, rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të stafit akademik ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentët.</p> <p>Funksionimi i sistemit të sigurimit të cilësisë përshkruhet në rregulloren përkatëse. Institucioni e monitoron cilësinë nëpërmjet Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë pranë secilit Fakultet. Në këtë Njësi përfshihen personel akademik i brendshëm i universitetit si edhe ekspertë të jashtëm. Kjo njësi është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. NJSBC monitoron cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin periodik, ndjekjen dhe zhvillimin e pyetësorit të stafit dhe studentëve për cilësinë e ofrimit të programeve të studimit, etj.</p> <p>[Dok. 64. Manuali i Cilësisë UBT]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UBT i nënshtrohet akreditimit të jashtëm periodik. UBT i është akorduar akreditimi institucional me Vendim BA Nr. 59, datë 16.12.2021, me kohëzgjatje 5 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 15.12.2026. Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Sistemet e Informacionit në Ekonomi” është licencuar përmes vendimit të Urdhërit të MASR nr.673 datë 12.10.2018 dhe vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi me qëllim akreditimin e programit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL. UBT bën përpjekje të vazhdueshme në kuadër të NJSBC-së, për përmirësimin e cilësisë.</p> <p>NJSBC ka hartuar paketën e instrumenteve të cilësisë dhe GVJ nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimi me NJSBC evidentoi zhvillimin e anketimeve me studentët në trajtën e pyetësorëve dhe transmetimin e informacionit te drejtuesi i Departamentit.</p>

	<p>GVJ konstatoi se ka patur hartim raportesh të vlerësimit për programin e studimit shoqëruar me analizë, ku integrohen rezultatet e pyetësorëve për vlerësimin e stafit akademik në nivel departamenti si dhe është operuar me nxjerrjen e konkluzioneve të pasqyruar në raporte si dhe me plan aksioni për të adresuar problematikën e konstatuar.</p> <p>[Dok. 14. 1. Certifikatë Akreditimi UBT.], [Dok. 19. Analiza Mësimore dhe Kërkimore Shkencore DMI.], [Dok. 20. 1. Analiza Mësimore Kërkimore FEA 2021-2022], [Dok. 32. 1. Pyetësori i studentëve online UBT.], [Dok. 32. 2. Format Pyetësori i studenteve FEA.]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB, sikurse edhe në vizitën në institucion, GVJ, evidenton se në nivel institucioni, në nivel fakulteti si edhe në nivel departamenti kryhen analiza dhe raporte të përvitshme në lidhje me treguesit e performancës së stafit akademik por edhe ecurisë së programit të studimit. Synimi i këtyre analizave nuk është vetëm të evidentohen pikat e forta apo edhe mangësitë por qëllimi kryesor është të hartohen e ndërmerren plane veprimi për përmirësim. Një rol të rëndësishëm në sigurimin e të dhënave sidomos në lidhje me mësimdhënien dhe performancën e stafit akademik kanë edhe studentët e programit të studimit, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve online.</p> <p>[Dok. 19. Analiza Mësimore dhe Kërkimore Shkencore DMI.], [Dok. 20. 1. Analiza Mësimore Kërkimore FEA 2021-2022], [Dok. 32. 1. Pyetësori i studentëve online UBT.]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka ngritur një sërë mekanizmesh në funksion të sigurimit të cilësisë së brendshme të tilla si: rishikimi i kurrikulave, rishikimi i syllabuseve në mënyrë periodike, disa mekanizma të vlerësimit të stafit akademik ku një rol të rëndësishëm luan vlerësimi nga studentët.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë</p>	<p>Bazuar në RVB sikurse edhe në vizitën në institucion, GVJ evidenton se në nivel Fakulteti sikurse edhe në nivel departamenti, bëhet analizë vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore. Në analizën e përvitshme të departamentit bëhet edhe analiza e programit të studimit duke nxjerrë në pak arritjet dhe dobësitë sikurse edhe plan veprimin për përmirësim të mëtejshme.</p>

<p>proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në rastet kur ka nevojë për përmirësim në programet mësimore dhe në kurrikul, këto ndryshime pasi miratohen në nivel departamenti dhe fakulteti i përcillen për miratim Sektorit të Programeve dhe Kurrikulave.</p> <p>[0.2 RVB_MP_MIA 13.02.2023.], [Dok. 20. 1. Analiza Mësimore Kërkimore FEA 2021-2022.], [Dok. 19. Analiza Mësimore dhe Kërkimore Shkencore DMI]</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Sikurse evidentuam edhe në kriterin më sipër, në nivel Departamenti dhe Fakulteti kryhet analiza vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore e cila finalizohet me një raport që ndër të tjera evidenton ecurinë apo problematikat e programit të studimit.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, bazuar edhe në raportin e analizës mësimore dhe kërkimore shkencore, hartohet plan veprimi për motivimin e praktikave të mira si edhe masat për problematikat e evidentuara.</p> <p>[Dok. 20. 1. Analiza Mësimore Kërkimore FEA 2021-2022.], [Dok. 19. Analiza Mësimore dhe Kërkimore Shkencore DMI.], [Dok. 24. Plan veprimi FEA 2022-2023]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni sikurse edhe gjate vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Institucioni përdor një sërë metodash për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së programit të studimit. Kështu në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti realizohet analiza mësimore dhe kërkimore shkencore, vlerësohet vazhdimisht kurrikula si edhe hartohet plan veprimi për përmirësime të vazhdueshme. Studentët gjithashtu kanë rolin e tyre në vlerësimin e stafit akademik, nëpërmjet anketimit I cili kryhet në përfundim të çdo semestri. Performanca e stafit akademik, në bazë të disa treguesve që lidhen me mësimdhënien, kërkimin dhe angazhimin e tyre, vlerësohet nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe asaj kryesore.</p> <p>[Dok. 20. 1. Analiza Mësimore Kërkimore FEA 2021-2022.], [Dok. 19. Analiza Mësimore dhe Kërkimore Shkencore DMI.], [Dok. 24. Plan veprimi FEA 2022-2023.], [Dok. 59. Format Vlerësim Performance.], [Dok. 32. 1. Pyetëtori i studentëve online UBT]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik,</p>	<p>NJSBC ka hartuar paketën e instrumenteve të cilësisë. Për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve, institucioni monitoron periodikisht nëpërmjet instrumenteve të mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i lëndës nga studenti (plotësohet nga çdo student përpara provimit të lëndës) 2. Vlerësimi për pedagogun (plotësohet nga studenti përpara zhvillimit të provimit)

<p>ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>3. Vlerësimi i performancës së personelit akademik (nga Drejtuesi i departamentit dhe Dekani)</p> <p>4. Përmbledhëse e veprimtarisë së pedagogut (mësimdhënie, kërkim shkencor, pjesëmarrje në projekte etj.)</p> <p>[Dok. 64. Manuali i Cilësisë UBT.], [Dok. 59. Format Vlerësim Performance], [Dok. 32. 1. Pyetëtori i studentëve online UBT]</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në RVB sikurse edhe në vizitën në institucion, GVJ evidenton se në nivel Fakulteti sikurse edhe në nivel Departamenti, bëhet analizë vjetore mësimore dhe kërkimore shkencore. Në analizën e përvitshme të departamentit bëhet edhe analiza e programit të studimit duke nxjerrë në pak arritjet dhe dobësitë sikurse edhe plan veprimin për përmirësime të mëtejshme.</i></p> <p><i>Në rastet kur ka nevojë për përmirësim në programet mësimore dhe në kurrikul, këto ndryshime pasi miratohen në nivel departamenti dhe fakulteti i përcillen për miratim Sektorit të Programeve dhe Kurrikulave</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="547 779 759 864"></th> <th data-bbox="759 779 973 864">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="973 779 1187 864">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1187 779 1410 864">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="547 864 759 911"></td> <td data-bbox="759 864 973 911"></td> <td data-bbox="973 864 1187 911"></td> <td data-bbox="1187 864 1410 911">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Pjesë e aktive e UPT është edhe Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor (Statuti i UBT, neni 18/1, pika 5 dhe 6). Sikurse cilësohet në Statutin e UBT (neni 18/1, pika 1 dhe 11), pjesë e Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor në nivel Institucioni dhe në nivel Fakulteti, janë stafi akademik dhe studentë të cilët përzgjidhen pas procesit të vetë-kandidimit sipas procedurave të përcaktuara.</p> <p>[Dok. 2. Statuti i UBT]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Sikurse edhe përcaktohet në Statutin e UBT, UBT është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Drejtoria përgjegjëse për ta kryer këtë përgjegjësi është Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë (DVBS). Në Statutin e UBT sikurse edhe në rregulloren e DVBS përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat që studentët, stafi akademik dhe ai ndihmës akademik, njësitë bazë dhe njësitë kryesore kanë për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet</p>	<p>[Dok. 2. Statuti i UBT, kreu IX, neni 83-86.], [Dok. 9. Rregullore DVBS]</p>

përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.									
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Ndër parimet kryesore të UBT, të shprehura edhe në rregulloren e Këshillit të Etikës, është edhe parimi i integritetit (parimi 2) dhe parimi i respektimit reciprok të anëtarëve të universitetit (parimi 4). Të gjitha procedurat, mënyrat dhe instrumentet e përdorura për vlerësimin e sigurimit të cilësisë bazohen në parimet e shprehura në rregulloren e Këshillit të Etikës. [Dok. 70. Rregullore e Këshillit të Etikes UBT]								
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Bazuar në RVB, si edhe në takimin që GVJ pati në institucion u konstatua se vazhdimisht merren parasysh mendimet e dhëna nga përfaqësues të bizneseve me të cilat UBT ka marrëveshje bashkëpunimi, sikurse edhe analiza e tregut të punës. Kjo ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Gjithashtu eksperiencia që stafi akademik ka në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, në kuadër të projekteve Erasmus, ndihmon gjithashtu në përmirësimin e vazhdueshme të lidhura me mësimdhënien, kërkimin shkencor etj.								
Konkluzione	<i>Të gjitha procedurat, mënyrat dhe instrumentet e përdorura për vlerësimin e sigurimit të cilësisë bazohen në parimet e shprehura në rregulloren e Këshillit të Etikës.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për	GVJ, konfirmon se përveçse dokumentacionit të plotë të vënë në dispozicion nga Institucioni në lidhje me procedurat dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në faqen ueb të UBT si edhe të FEA, janë publike informacione dhe një sërë dokumentacionesh dhe veprimtarish që lidhen me cilësinë. [https://www.ubt.edu.al/sigurimi-i-cilesise].

studentët dhe të gjithë të interesuarit.	[https://www.ubt.edu.al/rankimi-ne-web], [https://www.ubt.edu.al/certifikatat-e-akreditimit], [https://www.ubt.edu.al/botime-shkencore], [https://www.ubt.edu.al/projektet]								
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UBT, në bërjen publike të informacioneve respekton Kodin e Etikës sikurse edhe Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. [Dok. 70. Rregullore e Këshillit të Etikes UBT.], [Dok. 52. Ligji Nr. 9887 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale]								
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Sikurse edhe është theksuar në kriteret më sipër, pasi bëhet analiza mësimore dhe kërkimore shkencore në nivel departamenti dhe fakulteti, hartohen edhe masat në formën e plan veprimit për përmirësimin e dobësive të evidentuara në analizën e bërë.								
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	[Dok. 19. Analiza Mësimore dhe Kërkimore Shkencore DMI.], [Dok. 20. 1. Analiza Mësimore Kërkimore FEA 2021-2022.], [Dok. 24. Plan veprimi FEA 2022-2023]								
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni informon vazhdimisht dhe nxit studentët në pjesëmarrjen e tyre për plotësimin e pyetësorëve në përfundim të çdo semestri. Theksohet vazhdimisht tek studentët roli që ata kanë në monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë për programin e studimit duke i ndërgjegjësuar për plotësimin e pyetësorit online. Gjithashtu stafi akademik dhe ndihmës akademik kanë qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme në kuadër të sigurimit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë.								
Konkluzione	<i>Në faqen ueb të UBT si edhe të FEA, janë publike informacione dhe një sërë dokumentacionesh dhe veprimtarish që lidhen me cilësinë. Institucioni informon vazhdimisht dhe nxit studentët në pjesëmarrjen e tyre për plotësimin e pyetësorëve në përfundim të çdo semestri.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Menaxhim Informacioni në Agrobiznes” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime


1. Institucion me përvojë të gjatë akademike.
2. Staf i angazhuar në këtë program studimi, i kualifikuar dhe i angazhuar brenda fushës së tyre të ekspertizës dhe kualifikimit.
3. Ambiente, infrastrukturë dhe shërbime të konsoliduara në funksion të procesit mësimdhënës dhe administrativ.
4. Shërbimi i sekretarisë mësimore dhe shërbimeve për studentët efikas dhe i uniformuar në nivel universiteti.
5. Informimi i studentëve dhe kandidatëve për student, në takime periodike të mirë-organizuara në nivel institucioni.

Pika të dobta

1. Numër i ulët i studentëve të regjistruar në këtë program studimi.
2. Mesatare e ulët e studimeve bachelor për studentëve e regjistruar në këtë program studimi.
3. Mungesa e detajuar e aktiviteteve formuese, në veçanti e laboratorëve, në planet mësimore dhe syllabuset e lëndëve.

Rekomandime

1. Sugjerojmë rishikimin e kriterëve të pranimit për të përthithur studentë me formim më specifik bachelor në fusha të përafërta me ato të këtij programi studimi për të rritur cilësinë e tyre në hyrje.
2. Institucioni të hartojë syllabuset e lëndëve dhe planet mësimore të tillë që të paraqesin qartë ndarjen e aktiviteteve formuese (leksione, seminare, laboratorë detyra kursi, etj.) në kredite përkatëse si dhe orët në auditor për secilin aktivitet.
3. Ne si GVJ sugjerojmë institucionin, që edhe për praktikën profesionale, të hartojë një syllabus, ku të përshkruhen së paku detyrimet e studentit për vlerësimin e saj, si dhe detyrimet e studentit në zhvillimin e saj.
4. Ne si GVJ sugjerojmë institucionin, që në përcaktimin e koordinatorëve të programeve të studimit, të caktojë personel akademik me përvojë, por që nuk është i angazhuar në nivele drejtuese. Kjo për të lehtësuar dhe plotësuar punën administrative të drejtueseve (dekan, drejtues departamenti etj.) me ato të koordinatorëve të programeve të studimit.



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master "Information Management in Agribusiness" provided by the Higher Education Institution "Agriculture University of Tirana "

Strengths and affirmations

1. Institution with long academic experience..
2. Staff engaged in this study program, qualified and engaged within their field of expertise and qualification.
3. Environment, infrastructure and consolidated services in function of the teaching and administrative process.
4. The service of the teaching secretariat and services for students is efficient and uniform at the university level.
5. Informing students and student candidates, in well-organized periodical meetings at the institution level.

Weaknesses

1. Low number of students enrolled in this study program.
2. Low average grades of bachelor's studies for students enrolled in this study program.
3. Lack of detailed formative activities, especially laboratories, in lesson plans and course syllabi.

Recommendation

1. We suggest revising the admission criteria to absorb students with more specific bachelor's training in fields similar to those of this study program in order to increase their quality at the entrance phase.
2. The institution should draft course syllabuses and lesson plans in such a way that they clearly present the division of formative activities (lectures, seminars, laboratories, course assignments, etc.) into relevant credits as well as hours in the auditorium for each activity.
3. We as GVJ suggest the institution, also for professional practice, to draw up a syllabus, which describes at least the student's obligations for its evaluation, as well as the student's obligations in its development.
4. We as GVJ suggest the institution, in determining the coordinators of the study programs, to appoint experienced academic staff, but who is not engaged in management levels. This is to facilitate and complement the administrative work of managers (deans, department heads, etc.) with those of study program coordinators.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

